

# DORACAK PËR GAZETARË



PËR HULUMTIM DHE  
RAPORTIM NË LIDHJE ME  
FURNIZIMET PUBLIKE

## **DORACAK PËR GAZETARË**

**PËR HULUMTIM DHE RAPORTIM NË LIDHJE ME FURNIZIMET PUBLIKE**

Botues:

**Qendra e Komunikimeve Qytetare**

Autor:

**Sabina Fakiq dhe German Fillkov**

Përkthimi dhe lektura:

**Zeqirija Ibrahim**

Përgatitja dhe shtypi:

**Brigada dizajn**

Shtyp:

**Propoint**

Tirazhi:

**100 kopje**

# PËRMBAJTJA



5	HYRJE
7	FURNIZIMET PUBLIKE: RËNDËSIA DHE PRINCIPET
11	FAZAT E FURNIZIMEVE PUBLIKE
16	LLOJET E PROCEDURAVE TË FURNIZIMEVE PUBLIKE
20	PËRDORIMI I SISTEMIT ELEKTRONIK TË FURNIZIMEVE PUBLIKE (SEFP)
29	RREZIQET NGA KORRUPSIONI NË FURNIZIMET PUBLIKE
38	INSTITUCIONET KOMPETENTE NË FURNIZIME PUBLIKE



## HYRJE

**F**urnizimet publike ose sigurimi i mallrave, shërbimeve dhe punëve nga institucionet shtetërore, zakonisht nga ndërmarrje të sektorit privat, po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme edhe në Maqedoni. Çdo vit institucionet shtetërore shpenzojnë përafërsisht 800 milionë euro për t'u furnizuar me mallra, shërbime dhe punë që i sigurojnë përmes proceduarve për furnizime publike. Prandaj furnizimet publike janë shumë të rëndësishme për ekonominë e përgjithshme në vend, sepse ato në prodhimtarinë e përgjithshme vendore të mallrave dhe shërbimeve (BPV) marrin pjesë me 12%.

Institucionet shtetërore, përkatësisht njerëzit e punësuar në to, përmes furnizimeve publike, në fakt edhe i harxhojnë paratë që qytetarët i japin përmes tatimeve për funksionimin normal të shtetit. Prandaj, njëri ndër rekomandimet kryesore në nivel botëror është që gjatë shpenzimit të parave të qytetarëve dhe firmave, përkatësisht të parave publike – nëpunësit shtetërorë të sillen sikur shpenzojnë nga paratë e veta. Me fjalë të tjera, njëri nga parimet themelore të furnizimeve publike është që përmes tyre ta sigurojnë cilësinë më të mirë të mundshme për shumën e parave që jepen për furnizim. Me këtë rast nuk pritet të blihen prodhimet më cilësore, e as më të shtrenjtat. Pra, duhet të insistohet që të fitohet vlera e vërtetë për paratë e shpenzuara.

Që të mund të arrihet kjo, realizimi i furnizimeve publike duhet jetë i rregulluar me ligj, të sigurojë konkurrencë, trajtim të njëjtë dhe mosdiskrimin të ofertuesve, por edhe të mundësojë shfrytëzim ekonomik, racional dhe efikas të parave që harxhohen për furnizimeve. Meqë bëhet fjalë për shpenzim të parave të huaja, më saktë, të parave publike, gjithë ky proces duhet të jetë publik dhe transparent.

Rëndësia e transparencës buron edhe nga fakti se furnizimet publike, si aktiviteti më i rëndësishëm ndërmjet shtetit dhe firmave, janë edhe më shumë të rrezikuara nga korrupsioni, përkatësisht nga orientimi i parave publike në xhepa privatë. Meqë korrupsioni ngrihet mbi fshehjen, pikërisht transparenca është njëra ndër armët më të forta kundër tij.

Që qytetarët dhe firmat të jenë të sigurt se paratë e tyre shpenzohen në mënyrën më të mirë, në mënyrë racionale dhe efikase, njerëzit që i realizojnë furnizimet publike duhet të jenë të pastër për punën e tyre. Pastërtia e tyre, si njëri principet kryesore të furnizimeve publike, nuk duhet të jetë vetëm ndaj firmave pjesëmarrëse në procedurat e furnizimeve publike, por para së gjithash ndaj qytetarëve, përkatësisht ndaj përfaqësuesve të tyre në shoqëri – mediave dhe organizatave joqeveritare.

Prandaj mediat bashkë me sektorin joqeveritar, përkatësisht me të a.q. shoqëri civile, duhet të luajnë rol të rëndësishëm në përcjelljen e shpenzimit të parave publike dhe zbulimin e punës së paligjshme. Në fakt, qytetarët, vetëm përmes mediave, përkatësisht përmes hulumtimeve dhe analizave të gazetarëve, mund të informohen se a i shpenzojnë autoritetet shtetërore paratë e tyre në mënyrë racionale. Normalisht, për gjithë këtë nevojitet që mediat të kenë qasje në informacionet e vërteta për aktivitetet e autoriteteve dhe të dëshirojnë t'i marrin dhe të mund t'i japin ato informacione për opinionin.

Por, që të mund ta luajnë mediat rolin e tyre, gazetarët duhet të kenë edhe njohuri të caktuara për problematikën e furnizimeve publike. Meqë bëhet fjalë për një sferë më të ndërlikuar, që furnizimet publike të mund të përcillen, të hulumtohen dhe të raportohet për to, duhet të njihet mënyra dhe procedurat e realizimit të tyre.

Mediat mund të kenë rol të rëndësishëm në mundësinë që ua japin qytetarëve që t'i mbikëqyrin aksionet e nëpunësve publikë dhe ato informacione t'i shfrytëzojnë gjatë vendimeve të tyre votuese. Kjo mund të shpie deri te një pushtet që është më i përgjegjshëm dhe i cili i përmbush nevojat e qytetarëve të tij.

"The Right to Tell". 2002. World Bank Institute, Washington, D.C. p.45

Meqë përcjellja e zbatimit të furnizimeve publike, zbulimi i problemeve në këtë fushë dhe rekomandimi i masave që duhet të ndërmerren për tejkalimin e dobësive, si dhe për përparimin e sistemit të furnizimeve publike, tashmë disa vite është në fokus të veprimit të Qendrës së Komunikimeve Qytetare, që këtu buroi edhe nevoja për një doracak të këtyllë. Me këtë synohet që gazetarët, që gjithnjë e më shpesh raportojnë për furnizimet publike, të kenë para vetes një mjet praktik ndihmës, i cili do t'u mundësojë dhe do t'ua lehtësojë atyre hulumtimin dhe raportimin për furnizimet publike. Duke e pasur parasysh ndërlikueshmërinë e materies dhe përdorimin e shpeshtë të termave juridike, që nuk janë shumë të njohur për opinionin, autorët e doracakut u përpoqën ta thjeshtësojnë dhe përshtatin atë në një gjuhë më thjeshtë të komunikimit. Kështu para së gjithash do t'ua lehtësohet puna gazetarëve, por edhe publikut, përkatësisht qytetarëve, do t'u mundësohet ta kuptojnë më lehtë se si t'i shpenzohen paratë e tyre. Kështu, përmes raportimit më profesional dhe më cilësor për furnizimet publike, mediat do ta fuqizojnë presionin e tyre ndaj institucioneve shtetërore për më shumë transparencë, përgjegjësi dhe pastërti gjatë harxhimit të parave publike, por ashtu do të kontribuojnë edhe për zvogëlimin e keqpërdorimit dhe shfrytëzimit të furnizimeve publike për qëllime dhe interesa personale.

### Roli i mediave në furnizimet publike

Roli i mediave në furnizimet publike është i trefishtë.

E para, ato janë kanal i komunikimit për furnizimet publike dhe për përcjelljen e informacioneve zyrtare për furnizimet, siç janë botimi i konkurseve publike, i raportimeve për fituesit e furnizimeve etj. Mediat zakonisht janë vendi ku subjekte të ndryshme janë të detyruara me ligj t'i publikojnë informacionet në lidhje me furnizimet. Qëllimi i këtyre informacioneve shumë shpesh është që ta shtojnë njoftimin e bashkësisë furnizuese me tenderët dhe ashtu të forcohet konkurrenca, por kjo po ashtu duhet të shërbejë edhe për përmbushjen e detyrimeve të institucioneve që kanë të bëjnë e zbardhjen e informacioneve dhe të transparencës.

E dyta, roli i mediave në furnizimet publike është funksioni i tyre i "voçdog"-ut (qenit rojtar). Gazetaria hulumtuese mund të zbulojë parregullsi në furnizimet publike dhe ashtu t'i fuqizojë kërkesat për transparencë dhe autoritete më të përgjegjshme. Që mediat të jenë të suksesshme në kryerjen e këtij roli mbikëqyrës, ato duhet të jenë të lira dhe të pavarura nga ndikimet politike dhe ato të biznesit, si dhe të kenë qasje në informacionet për furnizime. Më tej, po ashtu është me rëndësi që mediat t'i kenë kapacitetet e nevojshme për realizimin e mbikëqyrjes. Komplexiteti i furnizimeve publike mund ta bëjë këtë të vështirë, por shumë institucione kompetente për furnizime publike realizojnë punëtori dhe trajnime për përfaqësues të mediave, gjë që gazetarëve u mundëson ta kuptojnë dhe hulumtojnë në mënyrë kritike atë fushë. Ndonëse mediat e kanë për detyrim edhe t'i analizojnë furnizimet publike, disa mendojnë se mbulimi shumë i madh medial fokusohet vetëm në skandalet dhe ka pak lajme pozitive për furnizimet.

E treta, mediat mund të shërbejnë si mjet edukimi në lidhje me furnizimet publike, duke e informuar opinionin më të gjerë për sistemin, rregullat, parimet dhe principet e furnizimeve publike.

Rasmus Jeppesen. 2010. "Accountability in Public Procurement". United Nation Procurement Capacity Development Centre, UNPCDC.

# FURNIZIMET PUBLIKE: RËNDËSIA DHE PRINCIPET


**Q**ë të kuptohet më mirë rëndësia e furnizimeve publike, duhet të kihet parasysh se furnizimet efikase publike nënkuptojnë rrugë më të mira, shkolla më moderne, spitale më të pajisura, shërbime më të mira për qytetarët. Përveç këtij kuptimi primar, furnizimet publike janë të rëndësishme edhe për faktin se për një pjesë të madhe të firmave ato mund të jenë burim serioz i aktiviteteve të tyre të biznesit. Mbi furnizimet publike ngrihet dhe përmes tyre zhvillohet një pjesë e madhe e ekonomisë së secilit vend. Derisa në vendet e Bashkimit Evropian vëllimi i furnizimeve publik është rreth 17% nga BPV-ja (Bruto Prodhimi Vendor) e BE-së, te ne furnizimet publike marrin pjesë me rreth 12% nga BPV-ja (në vitin 2009), me tendencë për rritje të vazhdueshme nga viti në vit edhe për nga numri i furnizimeve, por edhe për nga vlera e tyre. Vlera e kontratave të nënshkruara për furnizime publike në Maqedoni për vitin 2009 është 47.7 miliardë denarë ose rreth 776 milionë euro, që është 32% nga buxheti i përgjithshëm i vendit. Çdo vit në vendin tonë botohet rreth 7.000 shpallje për furnizime publike, ndërsa lidhen më shumë se 20.000 kontrata për furnizime publike. Vetë këto numra flasin për rëndësinë e furnizimeve publike jo vetëm për funksionimin normal të shtetit, por edhe për ekonominë e përgjithshme të vendit.

Me furnizim publik nënkuptohet sigurimi i prodhimeve, shërbimeve dhe punëve nga institucionet shtetërore, zakonisht përmes ndërmarrjeve të sektorit privat. Qëllimi kryesor i furnizimeve publike është që të sigurojnë prodhime, shërbime dhe punë sa më cilësore, për çmime sa më të ulëta. Që të mund të sigurohet kjo, shtetet krijojnë sistem të furnizimeve publike, i cili mundëson transparencë, efikasitet, kursim, përgjegjësi dhe garë korrekte ndërmjet ofertuesve të interesuar. Por, meqë furnizimet publike janë ndër fushat kryesore të ndërveprimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe private, ato janë edhe më shumë të ekspozuara ndaj aktiviteteve korruptuese, ryshfetit dhe favorizimit. Prandaj furnizimet publike janë objekt i analizës së shumë nismave nacionale, rajonale dhe ndërkombëtare të luftës kundër korrupsionit si një fushë e veçantë që duhet të reformohet. Xhejson Mateçak, Qendra e ndërmarrësisë ndërkombëtare private, Uashington DC, SHBA.


“

*Vlera e kontratave të nënshkruara për furnizime publike në Maqedoni për vitin 2009 është 47.7 miliardë denarë ose rreth 776 milionë euro, që është 32% nga buxheti i përgjithshëm i vendit.*

”



Vlera e furnizimeve publike në R.M.  
(në miliarda den.)



Përqindja e pjesëmarrjes së furnizimeve publike në BPB

*Principeve kryesore të furnizimeve publike: transparencë, konkurrencë, trajtim të barabartë të ofertuesve, mosdiskriminim, zbatim të ligjit, si dhe shfrytëzim ekonomik, efikas, efektiv dhe racional të mjeteve buxhetore, pastaj insistim që të arrihet oferta më e mira me kushte më të volitshme, si dhe raport për paratë e harxhuara gjatë furnizimeve.*

Pikërisht për arsye se gjatë furnizimeve publike ndodhin ndërveprimet më të mëdha ndërmjet sektorit shtetëror dhe atij privat, edhe vetë OECD-ja vazhdimisht tërheq vërejtjen se furnizimet publike janë edhe kërcënimi e rreziku më i madh për korrupsion. Prandaj shtetet në botë insistojnë t'i rregullojnë sistemet dhe proceset e furnizimeve publike në mënyrë sa më precize, që ashtu të sigurojnë funksionim të tyre më të mirë, që në këtë mënyrë të sigurojnë realizimin e principeve kryesore të furnizimeve publike: transparencë, konkurrencë, trajtim të barabartë të ofertuesve, mosdiskriminim, zbatim të ligjit, si dhe shfrytëzim ekonomik, efikas, efektiv dhe racional të mjeteve buxhetore, pastaj insistim që të arrihet oferta më e mira me kushte më të volitshme, si dhe raport për paratë e harxhuara gjatë furnizimeve.

Në Maqedoninë e pavarur deri tash janë miratuar tre ligje plotësisht të ndryshme për furnizimet publike. Ligji i parë për furnizime publike është miratuar në vitin 1998 (Gazeta zyrtare e R.M.-së nr. 26/1998 hyri në fuqi më 20 qershor të vitit 1998). Disa vite më vonë, në vitin 2004, u miratua një ligj tjetër (Gazeta zyrtare e R.M.-së nr. 19/2004, që hyri në fuqi më 7 prill 2004) dhe, përfundimisht, në vitin 2007 u miratua një ligj krejtësisht i ri, i hartuar sipas udhëzimeve të BE-së (Gazeta zyrtare e R.M.-së nr. 136/2007, që hyri në fuqi më 20 nëntor 2007). Teksti i pastruar i Ligjit të furnizimeve publike gjendet në ueb-faqen e Byrosë së Furnizimeve Publike (<http://javni-nabavki.finance.gov.mk>) në pjesën "Propisi".



### Principet themelore të sistemit të furnizimeve publike

Sistemi i furnizimeve publike patjetër duhet të bazohet në rregulla. Shtetet patjetër duhet të kenë kornizë të qartë dhe adekuate ligjore për zbatimin e furnizimeve publike. Ligjet, rregullativat, politikat dhe rregullat për zbatimin e furnizimeve publike duhet të promovojnë barazi (dhe të konsiderohen si korrekte nga të gjithë ofertuesit) dhe me këtë të dekurajohet diskriminimi dhe favorizimi...

Kjo do të thotë se, në garën për t'i fituar kontratat shtetërore, duhet të inkurajohet konkurrenca. Në shumicën e rasteve konkurrenca rezulton me cilësi më të mirë dhe shpenzime më të ulëta, dy gjëra që janë të dëshirueshme si rezultat i sistemit që funksionon mirë. Në disa raste, modelet alternative të ndarjes së kontratave mund të japin rezultate më të mira. Rregullat dhe rregullativa që e zbatojnë alternativat e tilla duhet të jenë të qarta dhe ta kufizojnë diskrecionin gjatë marrjes së vendimeve se kur duhet të shfrytëzohen.

Duhet të promovohet transparencja. Procesi i furnizimeve publike duhet të krijojë besim në opinionin se qeveria realizon shërbime legjitime për qytetarët, e jo se e shton pasurinë e përfaqësuesve qeveritarë dhe interesin e tyre të ngushtë privat. Mënyra më e mirë që të arrihet ky qëllim është që të sigurohet transparencë në marrjen e vendimeve, kjo gjatë gjithë procesit të furnizimeve publike, përkatësisht të dëshmojë se qeveria i shpenzon më përgjegjësi paratë e taksapaguesve... Me transparencë nënkuptohet "aftësia e pjesëmarrësve të interesuar që t'i njohin dhe t'i kuptojnë mjetet dhe procesin e dhënies dhe menaxhimit të kontratave. Kjo kërkon së paku botimin e informacioneve të nevojshme që do t'i mundësojnë një pjesëmarrësi mesatar ta dijë se si është parashikuar të punojë sistemi dhe se si në fakt funksionon ai".

Sistemi duhet ta fuqizojë përgjegjësinë. Nga nëpunësit publikë duhet të kërkohet përgjegjësi për zbatimin adekuat të rregullave dhe parimeve që i rregullojnë furnizimet publike, pra edhe për vendimet që i marrin. Përgjegjësia kërkon ekzistimin e një sistemi autentik ndëshkimor për shkeljet e rregullave, kjo në pajtim me procesin ligjor. Sistemi i tillë nënkupton pranim të procedurave adekuate për kontroll dhe revizion të brendshëm, sistem të ankesave për ofertuesit që kanë vërejtje ndaj vendimeve, si dhe trupa përkatës administrativë dhe gjyqësorë për revizion, që do të kenë autorizim për vendosjen e masave korigjuese dhe zgjidhjeve juridike.

Sistemi patjetër duhet të jetë ekonomik. Elementi themelor i kontratës së heshtur shoqërore ndërmjet qeverisë dhe qytetarëve është se qeveria i harxhon me kujdes dhe me efikasitet tatimet. Kjo për furnizimet publike do të thotë se qeveria siguron mallra, shërbime dhe punë me çmime dhe cilësi të arsyeshme, që do të thotë se ajo do të sigurojë vlerë të mirë për paratë e shpenzuara.

Sistemi duhet të jetë efikas. Koha është para dhe kalimi i saj kot do të thotë humbje parash. Rregullat dhe procedurat duhet të inkurajojnë realizimin e procesit të furnizimeve publike në periudhë të arsyeshme kohore dhe sigurim me kohë të mallrave, shërbimeve dhe punëve të furnizuara.

Edgardo Kampos deh Sanxhej Pradan, 2007, "Pasqyrat e shumta të korrupsionit", Banka Botërore, Uashington DC, SHBA.

### Shpjegime terminologjike

Ligji i furnizimeve publike shfrytëzon terma specifike të cilat gazetarët nuk është patjetër t'i vendosin në raportet e tyre, sepse bëhet fjalë për terminologji profesionale, e cila asnjëherë nuk mund të jetë e kuptueshme plotësisht për publikun. Por, për interpretim dhe përdorim të drejtë të atyre termave, megjithatë duhet të kihen parasysh këto shpjegime. Ligji nuk bën përkufizimin e furnizimeve publike, por e përkufizon procedurën e ndarjes së kontratës për furnizim publik si "procedurë që e zbaton një ose më shumë organe, qëllimi ose veprimtaria e të cilave është blerja ose përfitimi i mallrave, shërbimeve ose punëve".

“*Në sistemin elektronik të furnizimeve publike janë regjistruar gjithsej rreth 1.100 organe kontraktuese që furnizimet e tyre patjetër duhet t’i realizojnë sipas Ligjit të furnizimeve publike.*”

Kështu menjëherë arrijmë në njërin nga termat më shumë të përdorur në ligj “organet kontraktuese”, siç quhen me një fjalë të gjitha institucionet shtetërore me këtë ligj. Në to bien: organet shtetërore, njësitë e organeve të vetëqeverisjes lokale (komunat) dhe të Qytetit të Shkupit, ndërmarrjet publike dhe personat juridikë që janë themeluar me përcaktim specifik “për përbushjen e nevojave me interes publik”, që nuk janë me karakter industrial ose komercial dhe të cilat në masë të madhe janë të financuara nga organet shtetërore. Me fjalë të tjera, këtu bie Qeveria, ministritë, Kryetari i R.M.-së, komunat dhe institucionet komunale, pallatet e kulturës dhe ato rinore, agjencitë shtetërore, burgjet, bibliotekat publike, shoqatat shtetërore aksionare (siç është ELEM-in, Qendra Tregtare e Qytetit në Shkup, Posta e Maqedonisë etj.), gjykatat, teatrot shtetërore, muzetë, universitetet shtetërore, entet shtetërorë (të statistikës, të revizionit, të çështjeve të gjeodezisë etj.), shtëpitë e shëndetit, institucionet e mbrojtjes shëndetësore, spitalet dhe klinikat shtetërore, parqet nacionale, ndërmarrjet publike komunale, komisionet shtetërore (të letrave me vlerë, të marrëdhënieve me bashkësitë fetare etj.), Këshilli i Radio-Difuzionit, Banka Popullore, Drejtoria e Doganës, manifestimet

(si Mbrëmjet Strugane të Poezisë, Vera e Ohrit etj.), konviktet e nxënësve dhe të studentëve, fondet (e sigurimit shëndetësor, të ujërave, të sigurimit pensional dhe invalidor etj.) e të tjera. Në sistemin elektronik të furnizimeve publike janë regjistruar gjithsej rreth 1.100 organe kontraktuese që furnizimet e tyre patjetër duhet t’i realizojnë sipas Ligjit të furnizimeve publike. Termi vijues që përdoret në Ligjin e furnizimeve publike është “operatori ekonomik”, me të cilin nënkuptohen ofertuesit, përkatësisht firmat që paraqiten për të fituar furnizimet publike. Vetë ligji e përkufizon se “operator ekonomik” është ‘secili person fizik dhe juridik ose grup i atyre personave që ofrojnë në treg mallra, shërbime ose punë’. Në këtë kuptim, të gjithë ata operatorë ekonomikë që kanë dorëzuar ofertë quhen ‘ofertues’, ndërsa ata ofertues ose grupe ofertuesish që tashmë kanë nënshkruar kontratë për furnizim publik, përkatësisht që e kanë fituar furnizimin, përkufizohen si ‘bartës të furnizimit’. Vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet edhe termit ‘tender’, i cili në praktikë shpesh përdoret për ‘furnizim publik’. Edhe pse ‘tender’-i në kuptimin e tij dytësor është term më i gjerë se ‘furnizimi publik’, megjithatë edhe në vetë ligjin përdoret termi ‘dokumentacion i tenderit’ për dokumentet, informacionet dhe kushtet në lidhje me fletëparaqitjen për pjesëmarrje në furnizimin publik. Prandaj fjala ‘tender’ mund të përdoret në vend të ‘furnizimit publik’, por duhet të kihet kujdes që kjo mos të shkaktojë hutë, sepse secili furnizim publik mund të quhet tender, por secili tender nuk është furnizim publik. Fjala ‘tender’ nënkupton ofrim, garë dhe ankand, por nën ‘tender’ mund të nënkuptohen edhe lloje të tjera të garave ndërmjet firmave që bien në Ligjin e furnizimeve publike, siç janë, për shembull, koncesionet.

Të gjitha këto shpjegime duhet të kihen parasysht jo vetëm gjatë raportimit për furnizimet publike, por edhe gjatë leximit të këtij doracakut, sepse në të jo gjithnjë përdoren termat e njëjtë që janë përcaktuar me ligj. Megjithatë, në drejtim të kuptimit më të mirë, shpesh përdoren fjalë më të thjeshta, si: firma, institucione shtetërore, tenderë etj.

# FAZAT E FURNIZIMEVE PUBLIKE

**P**rocedura për furnizim zbatohet për çdo blerje mallrash, shërbimesh ose për realizimin e punëve, vlera e të cilave është mbi 500 euro, me disa përjashtime që janë precizuar në Ligjin e furnizimeve publike.

## Pragjet financiare në furnizimet publike

Pragu financiar	Mënyra e realizimit të furnizimit
Deri në 500 euro pa TVSH	Nuk zbatohet Ligji i furnizimeve publike, përkatësisht nuk zbatohet procedura për furnizim publik.
Prej 500 deri më 5000 euro pa TVSH	Mblidhen tre oferta pa publikim të shpalljes.
Prej 5000 deri më 20 000 euro pa TVSH për mallra dhe shërbime dhe deri më 50.000 euro për punë	Mblidhen tre oferta përmes publikimit të shpalljes.
Nga 20.000 deri në 500.000 euro pa TVSH për mallra dhe shërbime dhe prej 50.000 deri më 2.000.000 euro pa TVSH për punë	Zbatohet njëra nga procedurat për furnizim publik (e hapur, e kufizuar, bisedimi ose dialogu konkurrues).
Mbi 500.000 euro pa TVSH për mallra dhe shërbime dhe mbi 2.000.000 euro pa TVSH për punë	Shpallja publikohet edhe në Gazetën zyrtare të BE-së ose në botim tjetër përkatës.

Për furnizimet me vlerë deri më 5.000 euro dhe prej 5.000 deri më 20.000 për mallra dhe shërbime, përkatësisht deri më 50.000 për realizimin e punëve, zbatohet vetëm mbledhja e ofertave, me ose pa shpallje paraprake për ofertat.

Për furnizime më të mëdha se këto shuma zbatohet njëra nga procedurat për furnizime publike, të cilën si më adekuate do ta zgjedhë organi kontraktues: procedura e hapur, procedura e kufizuar, procedura e bisedimit dhe dialogu konkurrues. Por, ndonëse institucionet mund të zgjedhin se cilën nga këto procedura do ta zbatojnë, përsëri ekzistojnë disa rregulla që duhet të respektohen, të cilat janë shpjeguar në pjesën e secilës procedurë veçmas.

## Kur nuk zbatohet Ligji i furnizimeve publike


Ligji i furnizimeve publike i precizon këto raste, për të cilat nuk zbatohen parimet e Ligjit:

- Nëse kontrata është klasifikuar si sekret shtetëror;
- Për furnizime nga fusha e mbrojtjes, me ç'rast mund të zbulohen informacione me të cilat mund të rrezikohen interesat themelore të sigurisë së vendit që kanë të bëjnë me prodhimin dhe tregtinë me njerëz, municione dhe materiale e sisteme ushtarake;
- Kur për realizimin e kontratës nevojiten masa të veçanta të sigurisë dhe procedura në pajtim me rregullat e vlefshme aktuale;
- Gjatë blerjes ose marrjes me qira të tokës, ndërtesave ose pronës tjetër të patundshme;
- Gjatë blerjes, zhvillimit, produksionit ose koproduksionit të materialeve programore të radios ose televizionit;
- Shërbimet për arbitrazh dhe ndërmjetësim;

- Shërbimet financiare në lidhje me dhënie, tregtimin ose përcjelljen e letrave me vlerë, shërbimeve brokere, shërbimeve të Bankës Popullore;
- Shërbimet për zhvillim dhe hulumtim;
- Kontratat për furnizime publike për të cilat janë siguruar mjete nga organizatat ndërkombëtare (donatorë, huadhënës) ose nga vende të treta dhe kur për ato janë parashikuar kushte të veçanta për furnizim;
- Furnizime publike për nevojat e ARM-së për aktivitete ushtruese dhe për stërvitje për operacione humanitare ose paqësore, si dhe për mbrojtje kolektive jashtë R.M.-së;
- Furnizime publike të mallrave dhe shërbimeve në bazë të kontratës ndërkombëtare me qëllim të realizimit ose përdorimit të përbashkët të ndërtimit ose shërbimeve të dedikuara për projekte të përbashkëta.

### Fazat e furnizimeve publike

Ekzistojnë pesë faza kryesore në procedurat e furnizimeve publike:



#### 1. Marrja e vendimit për furnizim publik

Të gjitha furnizimet publike që i realizon një institucion duhet të jenë të parashikuara në planin vjetor për furnizime publike, që patjetër duhet të vendoset dhe miratohet në fillim të vitit, më së voni deri në fund të janarit.

Në plan theksohen:

- Mallrat, shërbimet dhe punët që i nevojiten institucionit;
- Vlerësimi i vlerës së llojeve të ndryshme të furnizimit;
- Procedurat e furnizimeve publike që do të zbatohen për blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve të nevojshme për t'u realizuar.

Nëse gjatë vitit bëhen ndryshime në nevojat ose buxhetin e institucionit, atëherë ai ka të drejtë ta ndryshojë ose plotësojë planin vjetor për furnizime publike. Megjithatë, me rëndësi themelore është të kihet parasysh se edhe gjatë hartimit, por edhe gjatë ndryshimit të planit të furnizimeve publike, institucionet nuk guxojnë që qëllimisht t'i ndajnë furnizimet e prodhimeve ose shërbimeve të njëjta vetëm që ashtu të përfitojnë disa kontrata me vlera më ulëta, që ashtu t'i shmangen publikimit të shpalljes (shpallja nuk publikohet për furnizime nga 500 deri më 5.000 euro). Për shembull, nëse është vlerësuar se gjatë vitit institucionit do t'i duhet letër për të shtypur në vlerë prej 7.000 eurosh, ai institucion nuk guxon ta ndajë furnizimin në dy pjesë ose në pjesë më të vogla dhe ashtu t'i shmangët detyrimin për publikimin e shpalljes për mbledhjen e ofertave, që në një mënyrë garanton transparencë të procedurës.

Secila procedurë e furnizimit publik fillon me marrjen e vendimit për realizimin e saj. Në vendimin për furnizimin publik institucionet e përcaktojnë:

- Llojin dhe sasinë e furnizimit;
- Burimin e parave të nevojshme për realizimin e furnizimit;
- Llojin dhe procedurën e furnizimit publik që do të zbatohet dhe
- Anëtarët dhe kryetarin e komisionit për furnizime publike.

Me këtë rast duhet të dihet se disa institucione kanë komisione të përhershme për furnizime publike, ndërsa në disa të tjera të gjithë të punësuarit rrotullohen si anëtarë të komisioneve për furnizime publike.

## 2. Përgatitja e dokumentacionit të tenderit

Pas marrjes së vendimit për furnizim, organi kontraktues duhet t'i përgatitë dokumentet dhe t'i përshkruajë kushtet dhe informacionet e nevojshme mbi bazë të të cilave firmat ofertuese do t'i përgatisin ofertat e tyre. Në të a.q. dokumentacion të tenderit, organi kontraktues duhet të përcaktojë:

- Kriteret që duhet t'i përmbushin firmat që të mund të marrin pjesë në furnizimin publik dhe dokumentet e nevojshme me të cilat do të dëshmojnë se ato janë të kualifikuara. Nga pjesëmarrësit e furnizimeve kërkohen dëshmi për ta vërtetuar gjendjen e tyre personale, aftësinë për kryerjen e veprimtarisë profesionale, aftësinë ekonomike dhe financiare, si dhe aftësinë teknike ose profesionale. Se cilat dokumente dhe kushte duhet t'i dorëzojnë dhe plotësojnë firmat që të dëshmojnë aftësinë e tyre, këtë e përcakton secili organ kontraktues sipas vlerësimit të tij. Në përgjithësi, për ta dëshmuar 'gjendjen personale', nga firmat kërkohen dokumente për të dëshmuar se firma nuk është në falimentim ose likuidim, se nuk ka tatime të papaguara, se nuk ka të shqiptuar ndalesë për të marrë pjesë në tenderë, se nuk ka ndalesë për kryerjen e veprimtarisë etj. Pastaj, për ta dëshmuar 'aftësinë për kryerjen e veprimtarisë profesionale' duhet të dorëzohet dokument se firma është e regjistruar për kryerjen e veprimtarisë nga fusha e lëndës së furnizimit publik. Për ta dëshmuar 'gjendjen ekonomike dhe financiare', nga firmat kërkohen certifikata përkatëse nga banka, bilance të gjendjes, fragmente nga bilanci i suksesit etj. 'Aftësinë e tyre teknike ose profesionale' firmat e dëshmojnë me listë të rekomandimeve paraprake që i ka pasur firma, duke e përshkruar pajisjen teknike, përmes deklaratave për përbërjen dhe kualifikimin e personelit, të blerësve më të mëdhenj etj. Institucionet që shpallin furnizime publike mund të kërkojnë nga firmat që të kenë edhe standarde për sistemet e cilësisë dhe/ose standarde për udhëheqje me mjedisin jetësor.
- Kriterin sipas të cilit do të zgjidhet oferta më e mirë, përkatësisht a do të jetë ky 'çmimi më i ulët' ose 'oferta më e volitshme ekonomike'. Nëse organi kontraktues përcaktohet për kriterin e dytë, përkatësisht për ofertën më të volitshme ekonomike, atëherë patjetër duhet ta përcaktojë qartë edhe prej cilave elemente do të përbëhet ky kriter dhe si do të jepen pikë për secilin prej atyre elementeve. Si elemente në këtë rast mund të jenë çmimi, cilësia, karakteristikat funksionale dhe teknike, karakteristikat ekologjike, shpenzimet operative, ekonomizimi, shërbimet e passhitjes dhe mbështetja teknike, afati i dorëzimit ose kryerjes, afati i pagesës etj. Për shembull, pikët maksimale që mund të merren përcaktohen 100. Nëse kriter për zgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm është 'çmimi më i ulët', atëherë ofertuesi me çmim më të ulët fiton më së shumti pikë dhe ai duhet ta fitojë tenderin. Nëse kriter është "oferta më e volitshme ekonomike", atëherë për secilin element përcaktohen pikët e mundshme në kuadër të shumës prej 100 pikë. Për shembull: 60 pikë për 'çmimin', 20 pikë për 'cilësinë dhe 20 pikë për 'afatin e pagesës'. Në këtë rast duhet të fitojë ofertuesi që ka fituar më shumë pikë si shumë e të tria elementeve.
- I a.q. specifikacion teknik, në të cilin në mënyrë precize janë përkufizuar kërkesat për cilësi, pamje, dimensione, mënyrë të paketimit dhe parametrat e tjerë për lëndën e furnizimit. Organet kontraktuese nuk guxojnë t'i përkufizojnë specifikacionet në shumë hollësi teknike në të cilat i referohen prodhimit konkret, realizimit, procesit ose markës tregtare, patentit ose prejardhjes specifike të mallrave, me qëllim që të favorizohen disa firma ose mallra e të eliminohen disa të tjera.
- Garancitë bankare ose mjetet e depozituara të firmave. Organi kontraktues në dokumentacionin e tenderit e përcakton edhe lartësinë e garancisë bankare për ofertën (e cila mund të përcaktohet në shumë maksimale prej 3% nga vlera e ofertës) dhe lartësinë e garancisë bankare për realizim cilësor të kontratës (e cila mund të lëvizë prej 5% deri në 15% nga vlera e kontratës).

Është me rëndësi të dihet se personat që kanë qenë të përfshirë në hartimin e dokumentacionit të tenderit nuk guxojnë pastaj të paraqiten si ofertues ose si anëtarë të ndonjë grupi ofertues të atij furnizimi publik.

Nga cilësia e hartimit të dokumentacionit të tenderit në masë të madhe varet edhe ajo se çfarë procedure cilësore për furnizim publik do të realizohet.

### 3. Zgjedhja e ofertës më të volitshme

Pasi të publikohet shpallja dhe të arrijnë ofertat e firmave ose pasi që organet kontraktuese pa konkurs t'i mbledhin ofertat e kërkuara, vijon faza e evaluimit (vlerësimit) të ofertave. Së pari kontrollohet se a i përmbushin firmat kriteret e kërkuara për aftësi, përkatësisht se a janë kualifikuar më tej për rrjedhën e mëtejme të procedurës – evaluimi i procedurave. Ofertat e firmave që nuk i përmbushin kriteret menjëherë hidhen dhe ato nuk merren më parasysh në fazën e mëtejme të evalumit. Dhënia e pikëve dhe zgjedhja e ofertës më të mirë bëhet në bazë të kriterëve që organet kontraktuese tashmë i kanë publikuar gjatë publikimit të shpalljes dhe i kanë precizuar në dokumentacionin e tenderit. Ashtu siç thamë, ekzistojnë dy kriteret për zgjedhjen e ofertës më të volitshme:

- Çmimi më i ulët
- Oferta më e volitshme ekonomike.

Në të dyja rastet më e volitshme është ajo ofertë që do të fitojë më së shumti pikë. Kur bëhet fjalë për 'çmim më të ulët', më e volitshme është ajo ofertë që kushton më pak. Por, kur është fjala për kriterin 'oferta më e volitshme ekonomike', atëherë më e volitshme është ajo ofertë që do të fitojë më shumë pikë nga elementet e ndryshme. Kështu, që të bëhet zgjedhja e duhur, më rëndësi është se a është precizuar në mënyrë të qartë në dokumentacionin e tenderit se si do të bëhet dhënia e pikëve për elemente të caktuara që gjenden në kriterin 'oferta më e volitshme ekonomike'.

Për shembull, nëse organi kontraktues e thekson në konkurs së kriter për zgjedhje janë çmimi (60 pikë) dhe cilësia (40 pikë), ai është i detyruar që në dokumentacionin e tenderit ta theksojë qartë se në bazë të çfarë nënelementeve do të vlerësohet kriteri 'cilësia'. Në të kundërtën, ka rrezik që pikët të ndahen në bazë të vlerësimit subjektiv të anëtarëve të komisionit.

Vendimi zyrtar për zgjedhjen e ofertës më të volitshme e merr personi përgjegjës i organit përgjegjës në bazë të propozimit të komisionit për furnizime publike. Me këtë rast personi përgjegjës është i detyruar ta pranojë propozimin e komisionit, përveç kur të gjykojë se zgjedhja është bërë në kundërshtim me Ligjin e furnizimeve publike. Pas kësaj, vijon njoftimi i firmave që kanë marrë pjesë në procedurë. Në këtë njoftim kandidatët informohen për zgjedhjen e bërë dhe jepen shkaqet se pse oferta të caktuara janë hedhur, pse janë vlerësuar si të papranueshme ose nuk janë zgjedhur për më të volitshme. Në veçanti është e rëndësishme që institucionet t'i arsyetojnë hollësisht vendimet e tyre për zgjedhjen e ofertës më të volitshme. Ato arsyetime, para së gjithash, u shërbejnë firmave si korigjuese, që ato ta dinë se ku është oferta e tyre më pak konkurruese nga ofertat e tjera. Përveç kësaj, firmat që nuk janë të kënaqura, pikërisht në bazë të këtyre arsyetimeve, duhet të bëjnë ankesë në komisionin e shkallës së dytë. Prandaj është shumë e rëndësishme që institucionet sa më hollësisht t'i arsyetojnë vendimet e tyre, sepse pa këtë firmat nuk do të kenë mundësi ta dinë se ku kanë gabuar ose të hartojnë ankesë të qëndrueshme për vendimin e komisionit të furnizimeve publike.

### 4. Nënshkrimi i kontratës

Nëse në afat prej 8 ditësh që nga marrja e njoftimit për zgjedhjen e ofertës më të mirë asnjë firmë nuk dorëzon ankesë, atëherë institucioni mund ta nënshkruajë kontratën për furnizim publik. Në rast se dorëzohet ankesë në Komisionin Shtetëror për Ankesa ndaj Furnizimeve Publike, atëherë organi kontraktues patjetër duhet ta presë epilogun e procedurës së ankesës dhe nuk guxon ta nënshkruajë kontratën, sepse komisioni i shkallës së dytë ndoshta mund ta pranojë ankesën dhe të kërkojë evaluim të ri të ofertave ose edhe ta anulojë plotësisht procedurën. Në afat prej 30 ditësh që nga nënshkrimi i kontratës,

*“ Është me rëndësi të dihet se personat që kanë qenë të përfshirë në hartimin e dokumentacionit të tenderit nuk guxojnë pastaj të paraqiten si ofertues ose si anëtarë të ndonjë grupi ofertues të atij furnizimi publik. Nga cilësia e hartimit të dokumentacionit të tenderit në masë të madhe varet edhe ajo se çfarë procedure cilësore për furnizim publik do të realizohet. ”*

organi kontraktues është i detyruar që në Byronë e Furnizimeve Publike të dorëzojë raport për kontratën e nënshkruar, që kjo të publikohet në Sistemin Elektronik i Furnizimeve Publike.

#### **5. Realizimi i kontratës**

Gjatë realizimit të kontratës për furnizime publike, institucionet duhet t'i respektojnë parimet për vëllimin dhe cilësinë e furnizimit, për afatet e dorëzimit ose të realizimit, si dhe për afatet e pagesës në vetë dokumentacionin e tenderit dhe në kontratën për furnizim publik. Realizimi i kontratave për furnizime publike nuk është përfshirë në Ligjin e furnizimeve publike, andaj kontrolli i plotë ndaj realizimit të kontratave është lënë në duar të vetë institucioneve.

# LLOJET E PROCEDURAVE TË FURNIZIMEVE PUBLIKE

**E**kzistojnë tetë lloje të procedurave për furnizimeve publike. Procedura sipas cilës do të blihen mallra, shërbime ose do të zgjidhet ndonjë realizues i punëve ndërtimore, kjo do të varet nga shuma e vlerësuar e furnizimit dhe nga specifika e lëndës për furnizim. Ligji i furnizimeve publike i parasheh këto procedura për ndarjen e kontratave për furnizime publike:

- Mbledhja e ofertave pa publikim të shpalljes;
- Mbledhja e ofertave me publikim të shpalljes;
- Procedura e hapur;
- Procedura e kufizuar;
- Procedura për publikimin e shpalljes me negociim;
- Procedura për publikimin e shpalljes pa negociim paraprak;
- Dialog konkurrues dhe
- Konkursi për zgjedhjen e zgjidhjes ideore.

## **Mbledhja e ofertave pa publikim të shpalljes**

Për furnizimet e ashtuquajtura të vogla deri në 500 euro, institucionet nuk publikojnë shpallje, por mbledhin oferta nga së paku tre firma dhe prej tyre e zgjedhin ofertën më të përshtatshme. Mirëpo, pasi që në vend ka më shumë se 1000 organe kontraktuese, shuma e të hollave, që harxhohet përmes këtyre “furnizimeve të vogla” është serioze dhe në nivel vjetor e tejkalon shumë prej 30 milionë eurosh, gjegjësisht kjo shumë është rreth 4% prej shumës së përgjithshme që harxhohet për furnizime publike. Aktualisht në Maqedoni nuk janë krijuar mekanizma, të cilat do të garantojnë qasje të barabartë të të gjitha firmave në furnizimet të vogla, për shkak se vetë institucionet vendosin se te cilat firma do të lëshojnë kërkesë për të dorëzuar ofertë. Në këto procedura jo vetëm që nuk publikohen shpallje, por as nuk ka hapje publike të ofertave, ndërsa institucionet nuk janë të detyruara të dorëzojnë raport SEFP (Sistem Elektronik i Furnizimeve Publike) për marrëveshjen e lidhur në afat prej 30 ditësh, por vetëm dy herë në vit dorëzojnë raport për furnizimet e këtilla. Në fakt organet kontraktuese janë të detyruara të mbajnë evidencë për procedurat me kërkesa për mbledhjen e ofertave dhe në formë elektronike të dorëzojnë kopje të këtij dokumentacioni në Byronë e të Hyrave Publike më së voni deri më 31 korrik, gjegjësisht deri më 31 janar për gjashtë muajt e kaluar. Këto evidenca mund të gjenden në SEFP.

## **Mbledhja e ofertave me publikim të shpalljes**

Nëse shuma e paraparë për furnizim është prej 5.000 deri më 20.000 euro për mallra dhe shërbime dhe deri më 50.000 euro për punime, atëherë organi kontraktues është i detyruar ta zbatojë procedurën për mbledhje të ofertave me anë të publikimit të shpalljes.

Sipas kësaj procedure, ofertat e pranuar të firmave hapen publikisht. Dallimi mes kësaj procedure dhe procedurave të tjera (për furnizime më të mëdha) qëndron në afatin më të shkurtër për dorëzimin e ofertave dhe në detyrimet më të lehta në lidhje me dokumentacionin e tenderit. Në fakt, për këtë lloj të procedurave, firmat nuk janë të detyruar që bashkë me ofertën të dorëzojnë edhe dokumente për ta vërtetuar potencialin personal dhe ekonomik, por mjafton që për të të dorëzojnë vetëm një deklaratë. Pastaj, pasi të zgjidhet oferta më e volitshme, firma që e ka fituar tenderin do ta vërtetojë deklaratën e dhënë edhe me dokumentacion zyrtar në lidhje me potencialin personal dhe ekonomik.



### Procedura e hapur

Kjo procedurë përdoret më së shpeshti për furnizime publike, përmes së cilës realizohen furnizime me mallra dhe shërbime me vlerë mbi 20.000 euro, gjegjësisht mbi 50.000 euro për realizim të punëve. Përmes këtij lloji të procedurave shpenzohen më shumë se 70% të të hollave të dedikuara për furnizime publike në Maqedoni. Për ta kuptuar më mirë këtë procedurë, e cila përdoret më së shpeshti, këtu do t'i paraqesim në detaje hapat e realizimit të saj.

Nga aspekti i ndjekjes së procedurave të hapura është i rëndësishëm fakti se shpalljet për të hyra publike, përveç asaj se patjetër duhet të botohen në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ato duhet të jenë në dispozicion edhe në Sistemin Elektronik të Furnizimeve Publike. Shpallja i përmban këto të dhëna themelore:

- llojin e furnizimit (çka bihet);
- mënyrën e marrjes së dokumentacionit të tenderit;
- afatin e fundit për dorëzimin e ofertave;
- datën dhe vendin e hapjes së ofertave.

Ofertat e dorëzuara nga firmat, në bazë të shpalljes për furnizim publik, hapen në mënyrë publike. Kjo do të thotë se gjatë hapjes së ofertave, përveç dorëzuesit të ofertës dhe anëtarëve të komisionit për furnizime publike, në këtë mund të marrin pjesë edhe gazetarë ose qytetarë tjerë të interesuar. Gjatë hapjes së ofertave mund të merren këto të dhëna:

- emrat e dorëzuesve të ofertave;
- çmimi i secilës ofertë, valuta në të cilën është dhënë shuma dhe lirimet eventuale të çmimeve;
- informacionet e tjera që kanë të bëjnë me elemente të tjera, të cilat vlerësohen (jepin pikë) në ofertë;
- garancitë e ofruara bankare të firmave.

Gjatë hapjes publike nuk guxon të përjashtohet asnjë ofertë, përveç atyre që janë dorëzuar pas skadimit të afatit.

### Procedura e kufizuar

Kjo procedurë realizohet në dy faza. Në fazën e parë bëhet zgjedhja e firmave, të cilat mund të marrin pjesë në tender. Në publikimin e shpalljes shënohen të gjitha kriteret dhe rregullat në bazë të së cilave do të përcaktohet kapaciteti i firmave dhe do të zgjidhen firmat e kualifikuara për fazën e dytë. Pas përfundimit të fazës së parë, gjegjësisht pas zgjedhjes së firmave të kualifikuara për të marrë pjesë në tender, organi kontraktues në të njëjtën kohë iu dërgon ofertë të gjithë kandidatëve të zgjedhur për fazën e dytë, që ata të dorëzojnë oferta. Numri i ofertave nuk guxon të jetë më pak se dy. Hapat vijues të kësaj procedure janë identike me ato të procedurës së hapur: mbledhja e ofertave, evaluimi i tyre, zgjedhja e ofertës më të volitshme dhe lidhja e marrëveshjes.

### Procedura për publikimin e shpalljes me negociim

Për zbatimin e procedurave me negociim me ose pa shpallje paraprake të konkursit, duhet të përmbushen disa parakushte ligjore. Këto procedura janë specifike për shkak se në to është zvogëluar në masë të konsiderueshme niveli i transparencës, madje edhe kur zbatohen me publikim të shpalljes, ngase organet kontraktuese zhvillojnë negociata të ndara me secilën firmë veçmas, me çka mundësohet subjektivitet në tërë procesin e zgjedhjes së ofertës më të volitshme. Prandaj këto procedura duhet të përdoren si përjashtime, e jo si rregull.

Vetë Byroja e Furnizimeve Publike në doracakun për realizimin e kësaj procedure vlerëson se "këto procedura janë më pak transparente në krahasim me procedurat e tjera për dorëzim të marrëveshjes dhe lënë më shumë hapësirë për sjellje subjektive të organeve kontraktuese, andaj mund të paraqesin rrezik të shfaqjes së praktikave korruptive. Zbatimi jo i

Hapat e procedurës së hapur për furnizim publik:

- Publikimi i shpalljes publike për të nënshkruar marrëveshje për furnizim publik
- Hapja publike e ofertave të dorëzuara nga firmat.
- Evaluimi i ofertave.
- Marrja e vendimit për zgjedhjen e ofertës më të volitshme.
- Informimi i firmave për vendimin e marrë.
- Nënshkrimi i marrëveshjes me firmën, oferta e së cilës është zgjedhur si më e volitshme.

rregullt i këtyre procedurave mund të shkaktojë dëme serioze në tregun e ndonjë vendi, madje edhe nëse nuk bëhet fjalë për praktikën korruptive të organeve kontraktuese”.

Institucionet mund të realizojnë furnizime publike përmes procedurës për negociim me publikim të shpalljes nëse paraprakisht kanë realizuar ndonjë procedurë për furnizim, në të cilën nuk është dorëzuar asnjë ofertë e pranueshme, kur natyra e furnizimit nuk lejon kurrfarë përcaktimi paraprak të vlerës së kontratës, gjegjësisht kur nuk lejon përcaktim preciz të specifikacioneve teknike ose kur realizohen furnizime për nevoja të hulumtimit, testimi ose zhvillimit.

Hapat e procedurës së publikimit të shpalljes me negociim paraprak:

- Publikimi i shpalljes.
- Vlerësimi i kapacitetit të firmave që shfaqin interesim të kandidohen.
- Marrja e vendimeve për përzgjedhjen e firmave kandidatë me të cilat do të negociohet.
- Dorëzimi i ftesave deri te kandidatët për dorëzimin e ofertave preliminare.
- Zhvillimi i negociatave me secilin kandidat ndaras.
- Zgjedhja e ofertës më të volitshme.
- Lidhja e marrëveshjes.

### Procedura për publikim të shpalljes pa negociim paraprak

Meqenëse bëhet fjalë për procedurë në të cilën nuk sigurohet as transparenca minimale, kjo procedurë duhet të përdoret në situata të rralla dhe përjashtuese. Sipas Ligjit të furnizimeve publike, kjo procedurë mund të përdoret nëse: në procedurën paraprake për furnizim publik asnjë firmë nuk ka dorëzuar ofertë; në situatë jashtëzakonisht emergjente, e cila nuk mund të parashihet, gjegjësisht kur organi kontraktues nuk ka pasur kohë të zbatojë procedurë të hapur; nëse për arsye teknike ose artistike, si dhe për shkak të mbrojtjes së të drejtave ekskluzive, marrëveshja për furnizim lidhet vetëm me një kompani, për hulumtim, eksperimentim, studim ose zhvillim, si dhe për shkak të distribuimit plotësues nga kompania me të cilën është nënshkruar marrëveshja me vlerë, e cila nuk guxon të tejkalojë 30% të marrëveshjes bazë.

Marrëveshjet e nënshkruara me negociim pa konkurs paraprak

ndryshe quhen “marrëveshje të drejtpërdrejta” ose “marrëveshje në katër sy”, gjë që bën me dije qartë për mungesën e transparencës së tyre. Në doracakun për realizimin e këtij lloji të procedurave, Byroja e Furnizimeve Publike potencion se “ajo që është karakteristike për këtë procedurë është mungesa e transparencës dhe mundësia për qasje subjektive të pjesëmarrësve kryesorë në procedurë, mungesa e mekanizmave kontrollues dhe mundësia e shfaqjes së praktikave korruptive.”

Përkundër thirrjeve dhe rekomandimeve për përdorim sa më të rrallë të procedurave për negociim me ose pa publikim të shpalljes paraprak të shpalljes, vlera e këtyre procedurave është mbi 7% nga numri i përgjithshëm i procedurat publike që realizohen në vend.

### Dialogu konkurrues

Kjo është procedura më e ndërlikuar nga të gjitha dhe përdoret vetëm në situata të jashtëzakonshme dhe për projekte të ndërlikuara infrastrukturore dhe informatike; për ndarje të koncesioneve për ndërtim; si dhe në partneritetin publik-privat. Në doracakun për dialogun konkurrues të Byrosë së Furnizimeve Publike jepet shembulli vijues: “Nëse synohet të lidhen dy brigjet e ndonjë lumi të madh, organi kontraktues nuk mund të përcaktojë se cila është mënyra më e mirë për ta bërë një gjë të tillë. A është më efikase lidhja me urë ose me tunel? Për cilën alternativë do të përcaktohen, kjo do të varet nga shumë faktorë, të cilat organi kontraktues nuk mund t’i shqyrtojë vetë në mënyrë objektive. Në këtë rast, dialogu konkurrues do t’i mundësojë organit kontraktues që ta dëgjojë mendimin dhe propozimet e firmave me përvojë në atë sferë, para se të marrë vendim sesi do ta bëjë lidhjen e brigjeve.”

Procedura “dialog konkurrues” i përfshin tre faza:

1. parakualifikimi i kandidatëve;
2. dialogu me kandidatët e zgjedhur dhe
3. dorëzimi e ofertave.

Në fazën e parë çdo firmë e interesuar mund të dorëzojë aplikacion për pjesëmarrje në dialog konkurrues, ndërsa numri i tyre duhet të jetë më shumë se tre.

Në fazën e dytë përfshihen vetëm ato firma që i kanë përmbushur kriteret për kapacitet e përcaktuara nga organi kontraktues. Në këtë fazë zhvillohet dialog me firmat e zgjedhura, që ashtu të përcaktohet zgjidhja më adekuate për furnizim, në bazë të së cilës më tej do të dorëzohen ofertat përfundimtare.

Në fazën e tretë organi kontraktues tashmë e ka identifikuar zgjidhjen më adekuate, ashtu që të gjithë kandidatëve të zgjedhur u bëhet thirrje të dorëzojnë oferta, pas së cilave vijon evaluimi dhe zgjedhja e ofertës më të volitshme.

### **Konkursi për zgjedhjen e zgjidhjes ideore**

Kjo procedurë është specifike, pasi që në vend të Komisionit të Furnizimeve Publike, zgjedhjen e personit fizik ose të kompanisë me të cilin/cilën do të nënshkruhet marrëveshje për furnizim publik për projekt ose për zgjidhje ideore e bën komisioni i jurisë i përbërë nga së paku tre anëtarë. Në fakt edhe për këtë procedurë publikohet shpallje dhe përgatitet dokumentacioni, në të cilin në mënyrë precize përcaktohet se çka është lënda e furnizimit dhe cilat janë kushtet minimale për ta vërtetuar kapacitetin e palëve që dorëzojnë oferta dhe, në fund, bëhet evaluimi i zgjidhjeve të ofruara.

### **Përdorimi i mjeteve elektronike për furnizime publike**

Institucionet kanë mundësi që zgjedhjen e ofertës më të mirë gjatë furnizimeve ta bëjnë edhe përmes mjeteve elektronike. Në fakt, tërë procedura për furnizim publik mund të zbatohet në formë elektronike ose vetëm për fazën përfundimtare duhet të zbatohet i a.q. ankand elektronik (e-ankandi). Ligji i furnizimeve publike nuk i ngarkon firmat me përmasën e caktuar të furnizimeve që duhet të realizohen plotësisht në formë elektronike, mirëpo ekzistojnë detyrime të përpikta ligjore për zbatimin e ankandit elektronik. Organet kontraktuese e kanë për detyrë që deri në fund të vitit 2011 ta përdorin ankandin elektronik deri në 705 prej numrit të shpalljeve për procedurë të hapur, për procedurë të mbyllur, për procedurë për publikim të shpalljes me negociim, për procedurë për mbledhje të ofertave me publikim të shpalljes. Për vitin 2012 është paraparë që 100% të këtyre procedurave të përfundojnë me ankand elektronik.

Ankandi elektronik zbatohet pasi që organet kontraktuese t'i marrin ofertat e firmave, pasi të bëhet hapja publike e ofertave, pasi të bëhet evaluimi i kapacitetit të firmave dhe ofertave të tyre. Ankandi realizohet në disa cikle, ku kompanitë me identitet të fshehur garojnë se cila do të japë çmim më të ulët dhe kushte të tjera më të volitshme për furnizim.

Konsiderohet se ankandi elektronik jo vetëm që bën kursimin e të hollave publike, por edhe i zvogëlon rreziqet nga korrupsion dhe keqpërdorimi. Përvojat e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dëshmojnë se me sistemit elektronik për furnizime publike, mund të kursehen edhe deri më 5% të mjeteve publike, përkatësisht 50-80% të shpenzimeve të organeve kontraktuese dhe firmave.

### **Çka është marrëveshja kornizë?**

Jo rrallë ndodh që gjatë procedurave për furnizime publike organet kontraktuese lidhin të a.q. marrëveshje kornizë. Fjala është për marrëveshje e cila lidhet me një ose më shumë kompani, në të cilën përcaktohen kushtet, në bazë të së cilave organi kontraktues do t'i nënshkruajë marrëveshjet për furnizime publike. Në marrëveshje më së shpeshti përkufizohet çmimi, sipas të cilit sigurohet ndonjë mall, shërbim ose realizohet ndonjë ndërtim. Jo gjithnjë në marrëveshje shënohet edhe sasia e furnizimit. Organet kontraktuese kryesisht lidhin marrëveshje kornizë kur e dinë se për një periudhë disavjeçare do të kenë nevojë për furnizim me atë lëndë, me çka kursejnë kohë dhe të holla, pasi që nuk e realizojnë procedurën. Marrëveshjet kornizë mund të nënshkruhen për periudhë kohore jo më të shkurtër se tre vite. Ajo që është me rëndësi të dihet është se marrëveshja kornizë nuk është marrëveshje për furnizim publik, që do të thotë se përzgjedhja e kompanisë nga e cila do të merret furnizimi mund të bëhet përmes mbledhjes së përsëritur të ofertave, përkatësisht përmes përzgjedhjes së ofertës më të volitshme. Firmat janë në pozitë të disfavorshme, sepse institucionet të cilat kanë nënshkruar marrëveshje kornizë me ta ka mundësi të mos e blejnë mallin, shërbimet ose punët, për çka kanë ato kanë marrëveshje në parim.


# PËRDORIMI I SISTEMIT ELEKTRONIK TË FURNIZIMEVE PUBLIKE (SEFP)

“

*Përveç lehtësimeve praktike për realizimin e furnizimeve publike, për gazetarët është shumë me rëndësi që SEFP-ja është bazë e pasur e të dhënave për furnizime publike, e cila mund të shërbejë si burim i informacioneve për raportet dhe për hulumtimet gazetareske.*

”

Sistemi Elektronik i Furnizimeve Publike (SEFP) është sistemi i vetëm i kompjuterizuar për realizimin e furnizimeve publike, që mund të gjendet edhe në internet, në adresën: <https://e-nabavki.gov.mk>, i cili mundëson furnizime publike më efikase dhe më transparente. Përmes këtij sistemi organet kontraktuese i plotësojnë dhe i publikojnë shpallje për furnizimet publike dhe shpalljet e kërkesave për mbledhje të ofertave, dokumentacionin e tenderit, raportet për marrëveshjet e nënshkruara, raportet për anulimin e procedurave, për ndryshimin ose plotësimin e shpalljeve, për dokumentacionin e tenderëve etj., ndërsa me këtë sistem mund të realizohen plotësisht edhe furnizime publike në formë elektronike ose të realizohen të a.q. ankande elektronike.




Përveç lehtësimeve praktike për realizimin e furnizimeve publike, për gazetarët është shumë me rëndësi që SEFP-ja është bazë e pasur e të dhënave për furnizime publike, e cila mund të shërbejë si burim i informacioneve për raportet dhe për hulumtimet gazetareske.

Qasja e gazetarëve në këtë sistem përmes internetit është falas; gjithçka që u duhet është një kompjuter dhe një lidhje e qëndrueshme e internetit.

Kërkimi në SEFP është i lehtë dhe i thjeshtë.

Nëse dëshirojmë t'i kërkojmë konkuret për furnizime publike gjatë periudhës njëvjeçare të ndonjë organi kontraktues, për shembull të Ministrisë së Ekonomisë, do të klikojmë në dritaren "Oglasi", e cila gjendet në pjesën e majtë të faqes së parë. Kur hapet dritarja, nga opsionet e dhëna, përsëri e zgjedhim dritaren e parë "Oglasi". Pastaj klikojmë në thjerrëzën e cila gjendet mbi fjalën "Baraj" dhe kështu na hapet menuja për të futur parametra për kërkim.



Le të themi se dëshirojmë t'i kërkojmë të gjitha shpalljet për furnizime publike të shpallura nga Ministria e Ekonomisë në vitin 2010.

Në "Status" e zgjedhim opsionin "Site", njësoj sikur edhe dritaren tjetër me opsionet "Vid na postapka". Te "Dogovoren organ" shënojmë "Ministerstvo za ekonomija". Këtu është shumë me rëndësi ta dimë emrin e saktë, me të cilin është regjistruar institucioni në SEFP. Këtë më lehtë mund ta bëjmë nëse klikojmë në kuadratin e kaltër, që gjendet në anën e djathtë të hapësirës për shënimin e organit kontraktues. Pastaj duhet ta shënojmë periudhën, për të cilën i kërkojmë shpalljet, që në rastin tonë është tërë viti 2010. Që të mund t'i shënojmë datat më lehtë, ato mund të përzgjidhen nga kalendarët me kalendare, që gjenden pikërisht afër fushave për shënimin e datave. Duke i lëvizë shigjetat për muajt (majtas - djathtas), ne shumë lehtë mund ta zgjedhim muajin e dëshiruar, ndërsa duke e klikuar në ditën përkatëse të muajit, mund ta zgjedhim datën e



saktë. Po ashtu vetë mund ta shënori datën, duke shënuar tire ndërmjet ditëve, muajve dhe vitit (p.sh. 01-01-2010). Pastaj klikohet në dritaren “Baraj”. Nga kërkimi shihet se Ministria e Ekonomisë në vitin 2010 ka publikuar 28 shpallje për furnizime publike, të cilat janë të radhitura në 3 tabela. Që të shkohet në secilën tabelë vijuese, thjesht duhet të klikohet në shigjetën djathtas, e cila gjendet në fund të tabelës. Siç mund të vërehet, për secilën shpallje të publikuar është dhënë numri, organi kontaktues, lënda e furnizimit publik, lloji i marrëveshjes, pra a është fjala për blerje të mallrave, shërbimeve ose punëve, lloji i procedurës së furnizimit publik, data e publikimit të shpalljes, afati i fundit për dorëzimin e ofertave dhe dokumenteve të shpallura në lidhje me konkursin, ku mund të vendoset dokumentacioni i tenderit, ndryshimet ose plotësimet e shpalljes ose dokumentacionit, raportet për marrëveshjet e lidhura ose për anulimin e procedurave, si dhe evidenca e mallrave të blera, shërbimeve dhe punimeve përmes të a.q. furnizime të vogla.

Датум на оглас	Договорни орган	Предмет на договорот	Вид на договорот	Вид на поставка	Датум на барај	Кривопис	Документи
21-07/2010	Министерство за економија	набавка на компјутери, патенти и контракти.	Служи	Барање за прибирање понуди	30.11.2010 13:00:00		
23-07/2010	Министерство за економија	набавка и изработка на ознаки и логотипи за аеролини...	Служи	Барање за прибирање понуди	25.11.2010 15:00:00		
1-07/2011	Министерство за економија	Организување на некои работи при регистрација и ...	Услуги	Барање за прибирање понуди	06.11.2010 14:00:00		
1-07/2010	Министерство за економија	изработка (градба) на комплексот Мандарино оазис.	Работи	Отворена поставка	02.11.2010 12:00:00		
10-07/2010	Министерство за економија	Северни и провиза опрема.	Служи	Барање за прибирање понуди	17.11.2010 14:00:00		
10-07/2010	Министерство за економија	Интернет услуги	Услуги	Отворена поставка	14.10.2010 14:00:00		
9-07/2010	Министерство за економија	УПС со генератор на струја за систем салн, преноси...	Служи	Отворена поставка	01.10.2010 11:00:00		
20-07/2010	Министерство за економија	Софтвер или сервис за апликација и управување на те...	Услуги	Барање за прибирање понуди	21.09.2010 14:00:00		
18-07/2010	Министерство за економија	изготвување на издолжителни податоци (перечне на прете...	Услуги	Барање за прибирање понуди	21.08.2010 14:00:00		
8-07/2010	Министерство за економија	Поправка и одржување на некои работи вклучувајќи...	Услуги	Отворена поставка	20.08.2010 11:00:00		

Me rëndësi është të dihet se në këtë tabelë mund të shihet edhe se cilat furnizime janë refuzuar, ndërsa cilat janë shënjuar me shenjën e trekëndëshit me pikëçuditëse dhe flamur të kuq. Nëse klikoni në të, do të hapet raporti për anulimin e procedurës bashkë me informacionin për shkaqet e anulimit. Në shembullin tonë, shenjë të tillë ka te furnizimi i tretë me numrin e shpalljes БППО/2011. Nëse klikojmë në shenjën për anulimin e procedurës, hapet raporti për anulimin e procedurës bashkë me informacionet për anulimin.

The screenshot shows the website 'Biro za javni nabavki' (Public Procurement Agency) with the following details:

- Navigation Menu:** Home, Procurement, Tendering, Information, News, Contact Us, Help.
- Search:** Користеначко име (Username), Лозинка (Password), and a 'Влез' (Login) button.
- Logo and Address:** Министерство за Финанси - Биро за јавни набавки, Ул.Димитрие Чуповски бр.11/БКАТ, 1000 Скопје, Република Македонија. Telephone: 02 3196-710/02 3126-027. Website: www.financa.gov.mk; http://javninabavki.financa.gov.mk.
- Notice Title:** ИЗВЕСТУВАЊЕ ЗА ПОНИШТУВАЊЕ НА ПОСТАПКАТА СО БАРАЊЕ ЗА ПРИЕМАЊЕ НА ПОНУДИ
- Reference:** Број на огласот за кој се однесува известувањето: 1-6990/2013
- Part I: Договoren Organ (Contracting Authority):**
  - I.1) Податоци за договорниот орган:
    - I.1.1) Име на договорниот орган: Министерство за економија
    - I.1.2) Адреса: ул.Јуреј Гагарин бр.15
    - I.1.3) Град и поштенски код:
    - I.1.4) Интернет адреса: www.economy.gov.mk
    - I.1.5) Лице за контакт: Елена Криваловска - Адреса на е-пошта: elena.krivalovska@economy.gov.mk - Телефон/Факс: 3093514/02 3093 482
  - I.2) Категорија на договорен орган, негова главна активност или дејност: Државни органи - Економија и финансии
  - I.3) Предмет на договорот за јавна набавка: Осигурување на моторни возила при регистрација и касно осигурување
- Part II: Information for Cancellation (Информации за поништувањето):**
  - II.1) Известувањето се однесува за: Поништување на дел/делови: **Не** Поништување на постапката: **Да**
  - II.2) Информации за причината за поништување на постапката: не е поднесена ниту една профитлива понуда
  - II.3) Датум на објав: 07-02-2013

Kthimi mbrapa përsëri bëhet përmes shenjës me dy viza majtas. Nëse klikohet në numrin e shpalljes për furnizim publik, atëherë do të kaloni në tekstin e plotë të shpalljes së publikuar nga palët kontraktuese. Kini kujdes kur të dëshironi të ktheheni në faqen paraprake. Nëse klikoni në sustën për e- kërkuesit tuaj të internetit për kthim prapa (back), atëherë do të ktheheni në nivelin para kërkimit dhe do t'i humbni të dhënat e kërkimit. Prandaj kthimin prapa do ta bëni përmes katrorit me dy shenja të kaltra, i cili gjendet në pjesën e sipërme të djathtë të fletës, menjëherë nën flamujt për zgjedhje të gjuhës. Çdo shpallje hapet duke klikuar mbi numrat dhe shkronjat e kaltra, të cilat paraqesin numrin e shpalljes në kolonën e parë të tabelës. Për shembull, nëse klikojmë në numrat e parë, do të na hapet shpallja për furnizim publik, ku, mes tjerash, do të mund ta kuptojmë se çka blihet, kur është afati për dorëzimin e ofertave, cilat janë kriteret për dorëzimin e marrëveshjes etj.

The screenshot shows the website of the Ministry of Finance - Bureau for Public Procurement (Biro za javni nabavki). The page displays an announcement for a public procurement (OGLAS ZA BARAÑE ZA PRIBIRAÑE NA PONUDI) for IT equipment. The announcement is dated 21-08/2010 and is for a contract (DEL E: DOGOVOREN ORGAN). The procurement is for a contract with the Ministry of Economy. The announcement includes details such as the location (Skopje), contact information (Elena Krizalovska), and the deadline for submission (August 31, 2010). The announcement is in Macedonian and is intended for public procurement.

**Министерство за Финанси - Биро за јавни набавки**  
 Ул. Денчиќ Чукоски бр. 11 | КАТ,  
 1000 Скопје, Република Македонија  
 Телефон: 02 2196-710/02 2424-027  
 www.finanse.gov.mk; http://javninabavki.finanse.gov.mk

**БИРО ЗА ЈАВНИ НАБАВКИ**

**OGLAS ZA BARAÑE ZA PRIBIRAÑE NA PONUDI**

Број на оглас: 21-08/2010

**ДЕЛ E: ДОГОВОРЕН ОРГАН**

I.1) Податоци за договорниот орган

I.1.1) Назив на договорниот орган: Министерство за економија

I.1.2) Адреса: ул. Јурај Гагарин бр.15

I.1.3) Град и поштенски код: Скопје 1000

I.1.4) Интернет адреса: www.economy.gov.mk

I.1.5) Лице за контакт: Елена Кризаловска Адреса на е-пошта: elena.krizalovska@economy.gov.mk Телефон/Факс: 3093514/02 3093 482

I.1.6) Дополнителни информации и тендерската документација може да се добие на следнаа адреса  
 Министерство за економија ул. Јурај Гагарин број 15, 1000 Скопје лице за контакт Драг Хајруковиќ, 3093435, www.daut@economy.gov.mk, http://javninabavki.finanse.gov.mk

I.2) Категорија на договорен орган, негова главна активност или дејност:  
 Државни органи-Економија и финансии

**ДЕЛ B: ПРЕДМЕТ НА ДОГОВОРОТ ЗА ЈАВНА НАБАВКА**

II.1) Предмет на договорот за јавна набавка:  
 Набавка на компјутери, калкулатори и монитори.

II.2) Вид на договорот за јавна набавка: Страна - Купување со одложено плаќање  
 Место на испорака на стоките или извршување на услугите, или локација на извршување на работите:  
 Министерство за економија ул.Јурај Гагарин број 15, 1000 Скопје

II.3) Дали договорот е од опфатените дејности (секторски договор):

II.4) Дали поставката ќе се спроведе Централно тело: Не

II.5) Главна набавка: Не

Për furnizimin e njëjtë, Ministria ka shpallur SEFP-në dhe dokumentacionin e tenderit, i cili mund të shihet nëse klikohet në shenjë për dokument “Word”, e cila gjendet në kolonën e fundit “Dokumenti” të tabelës themelore të shpalljeve. Në katorrin e njëjtë mund të vërehet edhe shenja në formë të librit të hapur. Kjo shenjë e paraqet evidencën e të a.q. furnizime të vogla, të cilat i ka realizuar Ministria. Në fakt, secili organ është i detyruar që dy herë në vit t’i dorëzojë ESFP-së evidencë për realizimin e furnizimeve të vogla: një herë në muajin e shtatë – për furnizimet e tilla brenda gjashtë muajve të parë të vitit dhe në janar, në vitin e ardhshëm – për gjashtë muajt e fundit të vitit paraprak. Pra, thënë ndryshe, të dorëzojnë dokumentacion për furnizimet e vogla në muajin vijues pas çdo gjashtë muajve. Në rastin tonë me Ministrinë e ekonomisë, kjo është e vendosur në rendin e parë, pranë raportit për furnizimin 21-BППО/2010. Evidenca hapet duke klikuar në shenjë në formë të librit të hapur. Nëse klikohet ajo shenjë, do të hapet evidenca për procedurat e furnizimeve publike, të cilat janë realizuar vetëm me marrje të ofertave: për periudhën prej 1 deri më 31 dhjetor të vitit 2010, përkatësisht për shtatë muajt e fundit të vitit.



**Министерство за Финанси - Биро за јавни набавки**  
 Ул. Делфина Чуповиќ бр. 11/Д КАТ,  
 1000 Скопје, Република Македонија  
 Телефон: 02 3196-718/02 3128-027  
 www.financ.gov.mk; http://e-nabavki.financ.gov.mk

**БИРО ЗА ЈАВНИ НАБАВКИ**

**ЕВИДЕНЦИЈА НА ПОСТАПКИТЕ СО БАРАЊЕ ЗА ПРИБИРАЊЕ НА ПОНУДИ**

За период : 01-07-2010 до 31-12-2010

**ДЕЛ I: ДОГОВОРЕН ОРГАН**

I.1) Податоци за договорниот орган  
 I.1.1) Назив на договорниот орган: Министерство за економија  
 I.1.2) Адреса: ул.Јуриј Гагарин бр.15  
 I.1.3) Град и поштенски код: Скопје 1000  
 I.1.4) Интернет адреса: www.economy.gov.mk  
 I.1.5) Лице за контакт: Елена Кржаловска Адрес на е-пошта: elena.krzhalovska@economy.gov.mk Телефон/Факс: 3093483/02 3093 482

**ДЕЛ II: ДОГОВОР ЗА ЈАВНА НАБАВКА**

II.1) Вид објектот на оглас (до 5000 евра)

Реден број	Предмет на договорот за јавна набавка	Вид на договор за јавна набавка	Број на доделен понуде	Склучен договор / доделен фактур			
				Износ/вредност на извршените работи / фактура со вклучен ДДП	Број на договорни / фактурни	Дата на договорни / фактурата	
1.	Печатени на Стратегија за развој на енергетиката на Република Македонија до 2020 година и превод од македонски на англиски јазик	Фулум		АЛКОМ Александар ДООЕЛ ул.Бенко Поповиќ Марко бр. 33 и.П. 1000 Скопје	24020 ден.	14-2912/15	03.08.2010
2.	Проба на Експерт за проценката за комплетот Македонско оро	Фулум		ГТН ПРОЦЕНКАТИ ИНТЕРФЛУТ ДОО Скопје ул.Варошката Ризаит бр.67-1	348504 ден.	14-27922/10	01.07.2010
3.	Креирање на ВЕБ-страница на Министерството за економија	Фулум		ВК Компјутерс ДООЕЛ испод мостот Стрела ул.Марија Ибевска бр.4 Стрела	297360 ден.	14-2911/9	20.08.2010
	Организациска настан и соработка			ИНТЕРН ДООЕЛ ул.Боре			

Evidenca ofron të dhëna për atë që është blerë, kur është marrë, nga kush dhe në çfarë vlerë. Nga kjo evidencë mund të shihet se në periudhën e paraparë, Ministria e Ekonomisë ka bërë 14 furnizime të mallrave, shërbimeve dhe punëve me vlerë deri më 5.000 euro, për të cilën shumë nuk ka nevojë të publikohet shpallje, 8 furnizime me vlerë prej 20 000 euro për mallra dhe shërbime dhe deri në vlerë prej 50.000 eurosh për punë për të cilat ka nevojë të publikohet shpallje. Nëse mbledhen vlerat e ndara të furnizimeve, do të shohim se Ministria në pjesën e dytë të vitit, sipas bazës së parë, ka shpenzuar 3.447.978 denarë, ndërsa sipas bazës së dytë 4.270.441 denarë ose gjithsej ka realizuar furnizime të ashtuquajtura të vogla në vlerë prej 7.718.419 denarësh ose rreth 125.000 euro.

Kontrollimi i evidencës për furnizimet e vogla mund të bëhet edhe në mënyrë tjetër, përmes dritares "Evidencija", e cila gjendet si nënmeny e dritares themelore "Izvestuvanja". Procedura është e ngjashme. Në fillim klikohet në shenjë me thjerrëz, e cila gjendet menjëherë afër fjalës "Baraj". Pastaj në menyne e kriterëve për kërkim plotësohen të dhënat e dëshiruara. Në rastin tonë shënojmë "Ministerstvo za ekonomija" periudha e kërkimit – prej 01-01-2010 deri në 31-12-2010 dhe pastaj e shtypim sustën "Baraj". Nga ky kërkim do të na shfaqen raportimet gjysmëvjetore për gjashtë muajt e parë dhe gjashtë muajt e dytë të vitit, me data të shënuara kur janë dorëzuar ato në Byronë e Furnizimeve Publike, përkatësisht me datën kur janë shpallur në SEFP.

Електронски систем за ЈАВНИ НАБАВКИ

Биро за јавни набавки

Министерство за финансии

Период за пребарување од: 01-01-2010 До: 31-12-2010

Договорен орган	Период	Датум на доставување	Датум на објава
Министерство за финансии	01.07.2010 - 31.12.2010	31.01.2011	31.01.2011
Министерство за финансии	01.01.2010 - 30.06.2010	30.07.2010	30.07.2010

Nga kjo mund të shihet se Ministria i ka dorëzuar në kohë të dyja raportet, respektivisht deri kah përfundimi i korrikut, për evidencën e gjashtë muajve të parë, si dhe deri në mbarim të janarit për evidencën e gjashtë muajve të dytë. Nëse hapet evidenca për gjashtë muajt e parë dhe ato të dhëna mblidhen me të dhënat për furnizime të vogla në gjashtë muajt e fundit (që e bëjnë më lart), do ta fitojmë shumën e përgjithshme të furnizimeve të vogla, që i ka realizuar Ministria e Ekonomisë gjatë vitit 2010.

Në menyren e njëjtë "Raportime" mund t'i marrim edhe informacionet për kontratat e nënshkruara të organeve. Kur klikojmë në sustën "Izvestuvanja za klucen dogovori", ndërsa në shenjën me thjerrëz i plotësojmë parametrat për kërkim në menyren speciale, e cila do të hapet në këtë rast. Këtu ka më shumë opsione për plotësim sesa në menyren e rëndomtë për kërkim, ashtu që kërkimi mund të bëhet më i fokusuar. Përveç në bazë të organit kontraktues, marrëveshjet e nënshkruara mund të kërkohen edhe në bazë të firmave të cilat i kanë fituar kontratat, në bazë të lëndës dhe llojit të marrëveshjes dhe në bazë të periudhës së furnizimit dhe nënshkrimit të marrëveshjes.

Për shembull, nëse dëshirojmë t'i kërkojmë të gjitha marrëveshjet që i ka lidhur Ministria e Ekonomisë në vitin 2010, në hapësirën për organin kontraktues e shënojmë "Ministerstvo za ekonomija" ose e zgjedhim "Ministerstvo za ekonomija" nga lista e organeve kontraktuese, ndërsa të "Datum na sklučuvanje na dogovor" e plotësojmë prej "01-01-2010 deri 31-12-2010". Pastaj e shtypim sustën "Kërko" dhe kështu na paraqiten dy faqe me gjithsej 19 të dhëna për kontratat e nënshkruara.

№ на оглас	Datumi na oglas	Preredit na dogovor	Vid na dogovor	Vid na postarka	Datumi na dogovor	Ime na nabavka	Primito otkup	Zemeno na dogovor	Datumi na dogovor
9-07/2010	09-07-2010	УПС за генератор на струја за систем с...	Страна	Отворена postarka	22-12-2010	ПРИСТАКА ИС Девел - Скопје	1887288.00 ден.	1791121.00 ден.	29-12-2010
9-07/2010	09-07-2010	Поправка и сервисирање на колони фран...	Услуга	Отворена postarka	24-12-2010	ДТУ КОЛЕВОВИЏОО Скопје	1820031.00 ден.	3000000.00 ден.	24-12-2010
9-07/2010	09-07-2010	Генерален информативен систем (ГИС) з...	Услуга	Отворена postarka	18-11-2010	Конзорциум Абино Сп. Невеста, Италија	2118844.00 ден.	2134533.00 ден.	01-12-2010
9-07/2010	09-07-2010	Датуми неволно истражувања на енерги...	Услуга	Отворена postarka	22-10-2010	Генер Крејс Инд Кицеф (Интернешнл) и дау...	3000000.00 ден.	189620.00 ден.	28-10-2010
9-07/2010	09-07-2010	Основни неволно истражувања за 2010 ...	Услуга	Отворена postarka	22-10-2010	ГЕОЛОПИНГ ДОО	1480000.00 ден.	342082.00 ден.	28-10-2010
9-07/2010	09-07-2010	Основни геолошки истражувања за 2010 ...	Услуга	Отворена postarka	22-10-2010	ГЕОЛОПИНГ ДОО	1480000.00 ден.	820112.00 ден.	28-10-2010
9-07/2010	09-07-2010	Основни геолошки истражувања за 2010 ...	Услуга	Отворена postarka	22-10-2010	Генер Крејс Инд Кицеф (Интернешнл) и дау...	1480000.00 ден.	489440.00 ден.	28-10-2010
9-07/2010	09-07-2010	Основни геолошки истражувања за 2010 ...	Услуга	Отворена postarka	22-10-2010	ГЕОЛОПИНГ ДОО	1480000.00 ден.	40002.00 ден.	28-10-2010
9-07/2010	09-07-2010	Основни геолошки истражувања за 2010 ...	Услуга	Отворена postarka	22-10-2010	Генер Крејс Инд Кицеф (Интернешнл) и дау...	1480000.00 ден.	348200.00 ден.	28-10-2010
9-07/2010	09-07-2010	Основни геолошки истражувања за 2010 ...	Услуга	Отворена postarka	22-10-2010	ГЕОЛОПИНГ ДОО	1480000.00 ден.	820112.00 ден.	28-10-2010

Përpos numrit, llojit dhe datës së marrëveshjes, lëndës së furnizimit dhe llojit të procedurës, merren edhe informacione edhe për bartësin e furnizimit, gjegjësisht për firmën me të cilën nënshkruhet marrëveshja për furnizim publik, për shumën e vlerësuar dhe për vlerën e marrëveshjes së lidhur nga rezultatet e kërkimit mund të vërehet se për një marrëveshje të njëjtë ka më shumë raportime, që do të thotë se për atë furnizim është lidhur marrëveshje me më shumë firma ose janë lidhur më shumë marrëveshje me firmat e njëjta (nëse është fjala për furnizim grupor). Në shembullin tonë i tillë është rasti me furnizimin nr 5-OP/2010, për të cilin janë nënshkruar 7 marrëveshje. Prandaj edhe numri "19" raportime për marrëveshjet e lidhura, që shfaqen pas kërkimit të bërë, ka mundësi të mos jetë fjala për 19 furnizime të bëra, për shkak se një furnizim mund të kryhet nga më shumë firma.

Në të njëjtën mënyrë mund të kërkohen edhe shumë informacione të tjera në SEFP, si e-furnizime të realizuara, e-ankande etj. Përveç kësaj, mund të merren informacione të dobishme edhe përmes kërkimit të firmave me të cilat institucionet shtetërore kanë nënshkruar marrëveshje për furnizime publike. Për shembull, nëse dëshirojmë të kuptojmë sesa marrëveshje dhe me cilat institucione ka nënshkruar marrëveshje ndërmarrja ndërtimore "Granit" SH.Q> Shkup gjatë vitit 2010, shkojmë në menynë "Izvestuvanja" dhe nga opsionet e dhëna e zgjedhim "izvestuvanje za skluçen dogovor". Kur të hapet menyuja për kërkim në pjesën "Nositel na nabavkata", aty e shkruajmë "Granit", ndërsa në hapësirë për shënimin e "Datum na skluçuvanje na dogovor", e shkruajmë "01-01-2010 deri në 31-12-2010". Kur ta shtypin sustën "Baraj", na paraqiten të gjitha marrëveshjet e furnizimeve publike, të cilat institucionet shtetërore i kanë nënshkruar me këto firma gjatë vitit 2010. Nga rezultatet e dhëna mund të shihet se bëhet fjalë për 16 marrëveshje.

№ на оглас	Договорен орган	Текст на договорот	№ на оглас	Вид на поставка	Датум на објавување	Ниво на набавка	Валутен износ	Побesitno dolozenie	Datum na objava
25-2303/2010	Opština Kočani	Acquisitoria na paten pravica: s. Vel...	Работо	Отворена поставка	13.12.2010	ГД „Транит“ АД	6084746.00 ден.	6171706.00 ден.	28.12.2010
07-09/2010	Агенција за државни патница	Испраќа на крај од ратоналет пат 12...	Работо	Отворена поставка	09.12.2010	ГД „ТРАНИТ“ АД - Скопје	3000000.00 ден.	2820827.00 ден.	11.12.2010
	Град Скопје	Испраќа на дополнително работо или на набавка на градски, сградно-инженер...	Работо	Поставка со преговори без преговори	22.11.2010	ГД „Транит“ АД, Скопје	20598411.00 ден.	24187566.00 ден.	04.12.2010
13/2010	Министерство за култура	Испраќа на изработка на проектни, сградно-инженер...	Работо	Отворена поставка	25.10.2010	ГД „ТРАНИТ“ АД	267820424.00 ден.	267820267.00 ден.	25.10.2010
05-43/2/2010	Opština Gornje Petrovo	Испраќа на изработка на проектни, сградно-инженер...	Работо	Отворена поставка	12.12.2010	ГД Транит АД Скопје	6000000.00 ден.	6167876.00 ден.	18.10.2010
078-572/2010	Opština Bitola	Изработка на проектни, сградно-инженер...	Работо	Отворена поставка	20.08.2010	Транит-Скопје,Ниво на набавка: Скопје,Скопје,Скопје...	29000000.00 ден.	23600000.00 ден.	08.10.2010
11/2010	Град Скопје	Изработка на проектни, сградно-инженер...	Работо	Отворена поставка	18.08.2010	ГД „Транит“ АД, Скопје	21188448.00 ден.	22423348.00 ден.	05.09.2010
126/2010	Opština Stružica	Испраќа на објект на работо	Работо	Отворена поставка	30.07.2010	ГД „Транит“ АД, Скопје	29314482.00 ден.	21048956.00 ден.	30.08.2010
03/2010	КП Новоградца - Битола	Испраќа на проектни, сградно-инженер...	Страна	Отворена поставка	26.03.2010	ГД Транит АД Скопје	10370000.00 ден.	4300000.00 ден.	03.08.2010
07-05/2010	Агенција за државни патница	Сопствени на објектите на патот А-302.	Работо	Отворена поставка	29.06.2010	ГД „ТРАНИТ“ АД - Скопје	10000000.00 ден.	6182296.00 ден.	08.07.2010

“*Është shumë me rëndësi që parametrat për kërkim të shënohen saktë, sepse sistemi është shumë i ndjeshëm. Pra, nëse shënohen të dhëna të gabuara, kjo nuk do të na japë kurrfarë rezultatesh (këtu para së gjithash është fjala për emërtimet e sakta të organeve kontraktuese, firmave, datave, llojeve të procedurave që kërkohen etj). Gjithnjë rekomandohet që, nëse është e mundur, të zgjidhen parametrat që i ofron sistemi, në vend se t’i shënoni vetë ato.*”

Edhe në këtë rast marrim të dhëna për organin kontraktues me të cilin është nënshkruar marrëveshja për lëndën e furnizimit, për llojin e procedurës për furnizim publik, për datën kur është nënshkruar marrëveshja, për vlerën e logaritimit të furnizimit, për vlerën e marrëveshjes dhe për datën e shpalljes së raportimit për marrëveshjen e lidhur. Nëse mbledhen vlerat e këtyre 16 marrëveshjeve, mund të shihet se gjatë vitit 2010 institucionet shtetërore me këtë ndërmarrje ndërtimore kanë nënshkruar marrëveshje me vlerë të përgjithshme prej 516.212.059 milion denarësh ose rreth 8.4 milionë euro. Nëse klikohet veçmas në secilën marrëveshje, gjegjësisht në numrat dhe shkronjat e kaltra, me të cilat është shënuar numri i shpalljes, atëherë mund të fitohen më shumë detaje për secilën marrëveshje veçmas.

Është shumë me rëndësi që parametrat për kërkim të shënohen saktë, sepse sistemi është shumë i ndjeshëm. Pra, nëse shënohen të dhëna të gabuara, kjo nuk do të na japë kurrfarë rezultatesh (këtu para së gjithash është fjala për emërtimet e sakta të organeve kontraktuese, firmave, datave, llojeve të procedurave që kërkohen etj). Gjithnjë rekomandohet që, nëse është e mundur, të zgjidhen parametrat që i ofron sistemi, në vend se t’i shënoni vetë ato. Vetëm nëse merren si shembull komunat, do të vërejmë se janë të shënuara ndryshe (,општина Битола’, ,општина Дебарца’, ,општина Чашка’, ,ЕЛС Осломеј’, ,ЕЛС Општина Берово’, ,Радовиш - орган на општината’, etj).

Në veçanti duhet pasur kujdes, kur bëhet fjalë për kërkimin e firmave, përkatësisht të operatorëve ekonomikë, sepse duhet të dihet emri i saktë i firmës. Në raste të tilla në SEFP nuk mund të zgjidhet nga lista ekzistuese e firmave, për shkak se një listë e tillë nuk ekziston. Prandaj rekomandohet që emërtimet e sakta të firmave të shikohen në ndonjë marrëveshje paraprake për furnizim publik.

# RREZIQET NGA KORRUPSIONI NË FURNIZIMET PUBLIKE

Fazat e procesit të furnizimeve publike	Reziqet kryesore nga korrupsioni
Marrja e vendimeve se cilat mallra, shërbime dhe punë do të furnizohen.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Furnizimi nuk është i patjetërsueshëm, ekonomikisht nuk është i justifikueshëm dhe nuk përputhet me nevojat reale.</li> <li>- Krijimi artificial i gjendjes së urgjencës së skajshme me qëllim që të nënshkruhet marrëveshje e drejtpërdrejtë.</li> <li>- Vlerësim i lartë dhe joreal i vlerës së furnizimit me qëllim që të krijohet mundësi për përfitim plotësues për ndonjë firmë.</li> </ul>
Përgatitja e dokumentacionit të tenderit (përkufizimi i karakteristikave të furnizimit)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përpunimi i dokumentacionit të tenderit në favor të kompanisë së preferuar.</li> <li>- Kufizimi i numrit të pjesëmarrësve përmes përcaktimit të kriterëve joreale që arrihen me vështirësi në lidhje me përcaktimin e kapacitetit ekonomiko-financiar dhe teknik të firmave.</li> <li>- Zgjedhja e kriterëve për vlerësim (dhënia e pikëve) të ofertave në favor të kompanisë së preferuar.</li> </ul>
Zgjedhja e ofertës më të volitshme.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi (evaluim) subjektiv dhe jo i drejtë i ofertave të firmave.</li> <li>- Anulimi i procedurave nëse nuk realizohen kalkulimet e planifikuara.</li> <li>- Zgjatja e tepërt e zgjedhjes së ofertës më të volitshme, me çka krijohet mundësi për garë mes firmave në dhënie të rryshfetit.</li> </ul>
Nënshkrimi i marrëveshjes për furnizim publik.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndryshimi i kushteve sipas së cilave nënshkruhet marrëveshja në interes të operatorit ekonomik.</li> <li>- Përfshirja e nënrealizuesve gjatë realizimit të furnizimeve publike, të cilët zgjidhen në mënyrë jotransparente.</li> <li>- Mungesa e transparencës gjatë shpalljes së marrëveshjeve të nënshkruara.</li> </ul>
Implementimi i marrëveshjes dhe mbikëqyrjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e mbikëqyrjes së fuqizuar në lidhje me mënyrën e nënshkrimit të marrëveshjeve.</li> <li>- Rrezik minimal nga sanksionimi i keqpërdorimeve të zbuluara në procedurat e furnizimeve publike.</li> <li>- Zgjatja e tepërt e realizimit të marrëveshjeve të ndara dhe vonimi i pagesës së të hollave si mënyrë për stimulim të rryshfetit.</li> </ul>



**F**urnizimet publike në përmasa botërore identifikohen si sferë e cila është më së shumti është e ekspozuar ndaj korrupsionit dhe keqpërdorimeve. Korrupsioni në furnizimet publike ndikon në efikasitetin e harxhimit të të hollave publike, shkakton humbje, e zvogëlon cilësinë e shërbimeve publike dhe mundësitë për përmirësimin e cilësisë së jetës. Korrupsioni në furnizime po ashtu ndikon negativisht edhe ndaj sektorit të biznesit, duke i rritur shpenzimet e firmave, duke e zvogëluar konkurrencën dhe duke e përkeqësuar klimën e biznesit. Rreziqet e korrupsionit ekzistojnë në të gjitha fazat e procedurave për furnizime publike që prej marrjes së vendimit për furnizim publik e deri në nënshkrimin e kontratës, përkatësisht të realizimit të saj.

Rreziqet kryesore të korrupsionit në faza të caktuar të furnizimeve publike

### **Rreziqet në fazën e marrjes së vendimit për furnizimet që do të realizohen**

Korrupsioni i kuptuar si keqpërdorim i pushtetit të dhënë publik për qëllime personale, mund të haset në forma të ndryshme – nga rryshfeti klasik i marrjes së përçindjeve për nënshkrim të marrëveshjeve për furnizime publike, e deri te nënshkrimi i marrëveshjes me firmën, e cila është e afërt me ndonjë individ të caktuar ose me partitë në pushtet. Në përmasa botërore konsiderohet se motivet për korrupsion duhet të kërkohen gjatë marrjes së vendimit për atë se çka duhet blerë ose çka duhet ndërtuar me të hollat publike. Në fazën e shpalljes së furnizimeve që duhet të realizohen dhe shumëve në të holla që do të nevojiten, furnizuesit potencialë me anë të korrupsionit mund ta iniciojnë “nevojën” e institucioneve për të blerë mallra, shërbime ose për të bërë ndërtime, të cilat i ofrojnë ata furnizues.

Zgjedhja se çka duhet blerë është në veçanti e theksuar në vendet me nivel më të ulët ekonomik, siç është Maqedonia, për shkak të kufizimit të buxheteve. Prandaj, në këto vende ekziston rrezik më i madh i shfaqjes së korrupsionit në fazën e parë të furnizimeve publike – gjatë marrjes së vendimit se cilat furnizime duhet realizuar. Rreziku më i madh e nxit edhe më tepër nevojën e hulumtimeve gazetareske pikërisht në këtë segment, që të analizohen furnizimet në prizmin e justifikimit të tyre, përkatësisht kursimit.

“*Furnizimi nuk është i patjetërsueshëm, ekonomikisht nuk është i justifikueshëm dhe nuk përputhet me nevojat reale.*

*Krijimi artificial i gjendjes së urgjencës së skajshme me qëllim që të nënshkruhet marrëveshje e drejtpërdrejtë.*

*Vlerësim i lartë dhe joreal i vlerës së furnizimit me qëllim që të krijohet mundësi për përfitim plotësues për ndonjë firmë.*

”

Në rend të parë duhet kushtuar vëmendje planit të furnizimeve publike. Në pajtim me Ligjin e furnizimeve publike, të gjitha organet kontraktuese janë të detyruara që në pajtim me burimet e përcaktuara të financimit, të hartojnë plane për furnizime publike për vitin vijues deri në fund të janarit. Edhe pse fjala është për dokumente publike, mund të themi se organet kontraktuese nuk preferojnë t’i publikojnë planet për furnizime publike nëpër ueb-faqet e tyre. Prandaj, që gazetarët të mund të kenë qasje në planet e organeve kontraktuese, ata duhet të thirren në Ligjin për qasje të lirë në informacione të karakterit publik.

Përmes një analize krahasuese të planeve për furnizim publik të disa viteve, mund të zbulohet furnizimi i shpeshtë i disa mallrave dhe shërbimeve nga viti në vit, si dhe rritja e furnizimeve të caktuara pa u rritur edhe nevojat ose vëllimi i punës. Si njëri ndër problemet e kësaj faze, të cilin në raportet e veta nga kontrollet e realizuara nëpër institucione, shpeshherë e ka konstatuar Enti Shtetëror i Revizionit është blerja e shpeshtë e mallrave të reja, për shkak të mungesë së evidencës precize për mallrat e ardhura. Kjo haset në veçanti në sektorin e shëndetësisë. Përveç kësaj, rrezik tjetër, të cilit duhet kushtuar vëmendje në këtë fazë është edhe krijimi artificial i nevojës për furnizim përmes paraqitjes joreale të dëmeve të pajisjeve.

Krijimi i gjendjes së urgjencës së skajshme, e cila është njëra ndër mundësitë ligjore për nënshkrimin e marrëveshjes së drejtpërdrejtë, është po ashtu ndër dyshimet e mundshme për korrupsion, ndonëse institucionet të cilat nënshkruajnë marrëveshje të këtilla më së shpeshti justifikohen se për arsye objektive nuk kanë mundur ta planifikojnë këtë furnizim në fillim të vitit, prandaj nuk e kanë paraparë në planin e furnizimeve publike. Rritja e vazhdueshme e vlerës së këtyre marrëveshjeve nga viti në vit gjithsesi se lë hapësirë dyshimi për keqpërdorim të mundshëm të kësaj zgjidhjeje ligjore. Prandaj është e patjetërsueshme që rregullisht të përcillen dhe të raportohen marrëveshjet e këtilla, të cilat ndryshe njihen edhe si “marrëveshje në katër sy”, që ashtu të fuqizohet presioni ndaj institucioneve për zvogëlimin e praktikimit të këtyre kontratave, përkatësisht të mundësohet transparencë e plotë në raste kur ato medoemos duhet të realizohen.

Njëri ndër rreziqet e tjera në fazën e sjelljes së vendimit për atë se çka do të blihet është edhe llogaritja e lartë dhe joreale e vlerës së furnizimit, që lë hapësirë të kuptohet se paraprakisht është llogaritur përfundimi plotësues i firmës e cila e ka fituar të drejtën për realizimin e furnizimit. Me qëllim të detektimit të rreziqeve të këtilla, vlera e furnizimeve të planifikuara dhe marrëveshja për furnizime publike duhet të krahasohen me çmimet e tregut për mallrat, shërbimet dhe punët e realizuara. Dallimet e mëdha mes çmimeve të tregut dhe atyre të furnizimit lënë hapësirë për dyshim se bëhet fjalë për korrupsion.

### **Rreziqet në fazën e përkufizimit të karakteristikave për furnizim**

Pasi organi kontraktues të marrë vendim formal për ndonjë furnizim të caktuar të mallrave, shërbimeve ose punëve, vijon përgatitja e të a.q. dokumentacion të tenderit, në të cilin në detaje përshkruhet lënda e furnizimit, përkufizohen kriteret të cilat duhet t’i përmbushin firmat që marrin pjesë në tender, por edhe kriteret sipas të cilave do të bëhet zgjedhja e ofertës më të volitshme. Në këtë fazë hasen disa rreziqe serioze, siç është përpunimi i dokumentacionit të tenderit në favor të kompanisë së preferuar; parashtrimi kriterëve joreale që arrihen me vështirësi në lidhje me përcaktimin e kapacitetit ekonomiko-financiar dhe teknik të firmave, që ashtu të kufizohet numri i pjesëmarrësve, por edhe zgjedhja e kriterëve për evaluim të ofertave në favor të ndonjë kompanie.

Ligji i furnizimeve publike parasheh se palët kontraktuese nuk kanë të drejtë t’i përkufizojnë specifikacionet teknike, të cilat shpijnë drejt prodhimit konkret, realizimit, procesit të caktuar ose shenjave tregtare, llojeve ose prejardhjeve specifike të mallrave, me qëllim të favorizimit ose eliminimit të operatorëve të caktuar ekonomik. Kjo praktikisht do të thotë se dokumentacionet e tenderit duhet t’i precizojnë detajet për prodhimet që duhet të blihen, por jo deri në atë masë sa të udhëzojnë për prodhime të caktuara. Përveç precizitetit të këtyre ligjit, në praktikë firmat njoftojnë për specifikacione teknike, të cilat sipas tyre haptas bëjnë thirrje për ndonjë prodhues ose ofrues konkret, me çka shkelet parimi i trajtimit të barabartë dhe i mosdiskriminimit të ofruesve. Përshtatja e dokumentacionit të tenderit dhe specifikimi i drejtë i një prodhimi të caktuar të ndonjë kompanie konkrete, gjithsesi se është një mënyrë më ndjeshme e të a.q. rregullim të tenderëve. Që të merren të dhëna për ekzistimin e këtij lloji të rrezikut në ndonjë procedurë të caktuar për furnizim publik, është e patjetërsueshme që jo vetëm të lexohen dokumentacionet e tenderit, por edhe të bisedohet me firmat pjesëmarrëse në tender, të cilat megjithatë e dinë më së miri nëse specifikacionet e theksuara për furnizim mundësojnë garë të drejtë ose janë diskriminuese dhe paraprakisht favorizojnë firma të caktuara. Për të fituar të dhëna për zbulimin e këtij lloji të abuzimeve, duhet të ndiqen edhe vendimet pas ankesave të Komisionit Shtetëror për Ankesa Ndaj Furnizimeve Publike, të cilat janë në dispozicion në ueb faqen e tyre [www.dkzjn.gov.mk](http://www.dkzjn.gov.mk). Në këto vendime mund të merren të dhëna për gjërat problematike të firmave në kontekst të dokumentacionit të tenderit dhe specifikacioneve, si mënyrës se si është përcaktuar komisioni i shkallës së dytë në lidhje me ankesat e tyre.

Kriteret, të cilat duhet t’i plotësojnë firmat, me qëllim që të marrin pjesë në tender (gjendja personale, kapaciteti për realizimin e veprimtarisë profesionale, gjendja ekonomike dhe financiare, gjendja teknike ose profesionale, si dhe plotësimi i standardeve për sisteme të cilësisë) paraqesin garanci për organet kontraktuese se firmat kanë kapacitet që pa kurrfarë pasoje ta realizojnë kontratën për furnizim publik. Mirëpo, shpeshherë vlerësohet se jo vetëm në Maqedoni, por edhe në përmasa botërore është i pranishëm rreziku i parashtrimit të kriterëve joreale, të cilat janë pothuajse të përcaktuara, me qëllim të përcaktimit të kapacitetit ekonomiko-financiar dhe teknik të firmave, që ashtu të kufizohet numri i pjesëmarrësve në tender dhe të përshtaten kriteret e tilla në favor të kompanisë së preferuar. Ankesat, të cilat i dorëzojnë firmat para Komisionit Shtetëror për Ankesa ndaj Furnizimeve Publike vërtetojnë se kriteret për vërtetimin e kapacitetit të firmave përdoren si mekanizëm efikas për favorizimin e ndonjë firme. Nga firmat shpeshherë kërkohet qarkullim i lartë vjetor i

“

*Përpunimi i dokumentacionit të tenderit në favor të kompanisë së preferuar.*

*Kufizimi i numrit të pjesëmarrësve përmes përcaktimit të kriterëve joreale që arrihen me vështirësi në lidhje me përcaktimin e kapacitetit ekonomik-financiar dhe teknik të firmave.*

*Zgjedhja e kriterëve për vlerësim (dhënia e pikëve) të ofertave në favor të kompanisë së preferuar.*

”

mjeteve financiare gjatë disa viteve të fundit dhe aty potencohet qartë pajisja që duhet ta posedojnë, kërkohet një numër i madh i kontratave paraprake për furnizime të njëjta, madje me vlerë edhe më të lartë, me numër të madh të punëtorëve dhe profesionistëve, si dhe me posedim të standardeve të cilësisë, të personave përgjegjës për cilësinë etj. Me parashtrimin e këtillë të kriterëve, të cilat më së shpeshti nuk janë në proporcion me llojin dhe vëllimin e furnizimit, thjesht favorizohet ndonjë firma dhe eliminohet konkurrenca. Në këtë mënyrë qysh në fillim u pamundësohet të marrin pjesë në procesin e furnizimit firmave, të cilat ndoshta janë të reja në treg ose që në nivel vjetor kanë qarkullim më të vogël të mjeteve, gjë që nuk do të thotë se kanë më pak njohuri ose se kanë më pak përvojë përkatëse. Me rregullimin e këtillë të tenderëve vjen në pyetje edhe shpenzimi racional dhe efikas i të hollave publike, për shkak se ashtu shtypet konkurrenca ndërmjet ofruesve. Konkurrenca në procedurat për furnizime publike është e rëndësishme për shkak se ajo duhet të rezultojë me çmim më të ulët dhe me cilësi më të mirë, si dhe të krijojë garë ndërmjet furnizuesve, që kështu të fitohet vlera më e mirë për të hollat e shpenzuara.

Prandaj, gjatë hulumtimit të rregullsisë së tenderëve të caktuara, me rëndësi është t'u kushtohet vëmendje kriterëve të parashtruara për kualifikim të firmave për pjesëmarrje. Një numër i vogël i pjesëmarrësve në tenderë të caktuar, në veçanti për furnizim të mallrave, shërbimeve ose punëve për të cilat dihet se në treg ka shumë kompani, duhet trajtuar si indikatorë për parregullsi eventuale.

Gjithnjë duhet të insistohet që kriteret për pjesëmarrje të firmave për furnizime publike të jenë adekuate, gjegjësisht në proporcion me atë që blihet (edhe sipas llojit edhe sipas vlerës së furnizimit). Gjithsesi se kjo nuk do të thotë se duhet të ulen kriteret në dëm të realizimit cilësor të kontratave për furnizime publike. Gazetarët mund t'i referohen nenit 144 të Ligjit të furnizimeve publike, i cili në mënyrë precize parasheh se “organi kontraktues në dokumentacionin e tenderit i thekson kushtet minimale, të cilat duhet t'i përmbushin operatorët ekonomikë, me qëllim që të kualifikohen”, si dhe se “organi kontraktues nuk ka të drejtë të kërkojë plotësimin e disa kushteve minimale në lidhje me gjendjen ekonomike dhe financiare, si dhe kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë, që nuk janë në proporcion me lëndën e kontratës për furnizim publik”.

Potencimi i përvojës së kaluar të firmave, insistimi në numrin madh të punëtorëve dhe të sasisë së pajisjeve, logjikisht mund të trajtohet si orvatje e mundshme e organeve kontraktuese për ta ngushtuar rrethin, kjo në favor të firmave të mëdha me përvojë shumëvjeçare, që kështu të pamundësohet pjesëmarrja e më shumë operatorëve ekonomikë në tender.

Për sa u përket kriterëve për zgjedhjen e ofertës më të volitshme, e cila po ashtu theksohet në dokumentacionin e tenderit, Ligji i furnizimeve publike, siç kemi shpjeguar, i përcakton dy lloje të kriterëve për zgjedhjen e ofertës më të volitshme: çmimi më i ulët dhe oferta më e volitshme ekonomike.

Organet kontraktuese vendosin vetë se cilin kriter në cilin furnizim do ta zgjedhin, madje nëse përcaktohen për kriterin “ofertë më e volitshme ekonomike”, ato vetë vendosin po ashtu edhe se cilat elemente do t'i fusin në të dhe sa pikë do t'ua ndajnë.

Kjo hapësirë e gjerë për parashtrimin e kriterëve për zgjedhje të ofertës më të volitshme, që me ligj u jepet organeve kontraktuese, në praktikë lë hapësirë për keqpërdorime subjektive, përkatësisht mundëson përshtatje të kriterëve për zgjedhje sipas përparësive të kompanisë që dëshirojnë ta favorizojnë. Në praktikë shumë shpesh ndodhë që organet e ndryshme kontraktuese për furnizim të lëndës së njëjtë të parashtrorin kriterë dhe elemente krejtësisht të ndryshme.

Këto manipulime të mundshme gjithnjë duhet të merren parasysh. Për shembull, nëse përparësia e kompanisë së favorizuar është çmimi i ulët, atëherë si kriter për zgjedhje përcaktohet vetëm “çmimi më i ulët”. Pastaj, nëse organi kontraktues



planifikon të nënshkruajë aneks-kontratë për rritjen e vlerës së kontratës së ndarë për 30% (për çka ka mundësi ligjore), përsëri në tender shkon me kriterin “çmimi më i ulët”.

Problemi është se firma tjera –ofruese, përveç palës së favorizuar, nuk e di qëllimin e nënshkrimit të anekseve për rritjen e vlerës, andaj ofertat e tyre do të jenë më të shtrenjta se oferta e firmës së favorizuar, e cila më vonë çmimin e ulët me të cilin e ka fituar tenderin do ta kompensojë me rritjen e vlerës për 30% me anë të aneksit. Është normale të dyshohet se në ato 30% do të ketë të holla edhe për korrupsion.

Në raste tjera, përparësia e kompanisë së favorizuar është “cilësia” e prodhimeve dhe shërbimeve të saj gjatë evaluimit (dhënies së pikëve), ku theksohet cilësia pikërisht në elementet për të cilat kompania e favorizuar ka përparësi. Në raste të këtylla për manipulim më se shpesh përdoren elementet: afati i pagesës, afati i dorëzimit e të ngjashme, të cilat më tej gjatë realizimit nuk ka fare nevojë të respektohen.

Përvoja nga ndjekja dhe hulumtimi i përvojave për furnizime publike dëshmon se gjatë përcaktimit të kriterëve për zgjedhjen e ofertës më të volitshme, jo vetëm që nuk ka rregulla në praktikë, por edhe nuk ekziston ndonjë logjikë e përgjithshme, e cila mund të ndiqet. Për shembull, skajshmërisht i dyshimtë mund të jetë furnizim përmes kriterit “oferta më e volitshme ekonomike”, në të cilën janë parashtruar këto elemente: “cilësia” – e cila sjell 70 pikë dhe “çmimi” i cili sjell 30 pikë. Pasi që ka dallim të madh në raportin mes cilësisë dhe çmimit, kjo në favor të cilësisë, nuk është aspak e çuditshme që në fund kontrata i jepet ofruesit me çmim shumë më të lartë në krahasim me konkurrentët tjerë.

Problemet me parashtrimin e kriterëve për zgjedhjen e ofertës më të volitshme janë konstatuar edhe nga Komisioni Shtetëror për Ankesave ndaj Furnizimeve Publike dhe nga Enti Shtetëror i Revizionit. Në fakt KSHAFP-ja vlerëson se “institucioni ‘oferta më e volitshme ekonomike’ nuk është përpunuar sa duhet që të mund të zbatohet në rast se zbatohet kriteri i çmimit më të ulët”. Në disa raporte, Enti Shtetëror i Revizionit konstaton se mosekzistimi i kriterëve të përcaktuara paraprakisht për vlerësimin elementeve të ofertës me të volitshme ekonomike krijon mundësi për subjektivizëm gjatë vendimmarrjes. Revizorët i zbulojnë këto dobësi: nuk janë dhënë shpjegime dhe nuk mund të verifikohet se çfarë kriteresh zbatohen gjatë evaluimit të cilësisë; shpeshherë ndodhë që si kriter për zgjedhjen e ofruesit më të mirë të shfrytëzohen afati i pagesës ose afati i realizimit, të cilat nuk respektohen gjatë pagesës, por thjesht jepen si mundësi për zgjedhje të ofruesit të favorizuar; hasen oferta me afat disaditor për realizim, edhe pse është e qartë se gjatë atij afati nuk mund të realizohen punët, ndërsa për pagesa japin afat të prolonguar mbi një vjet; në afatin e pagesës së furnizuesve jepet numri maksimal i pikëve, që ka ndikim të rëndësishëm ndaj radhitjes së pozitës së parë, edhe pse në praktikë pagesa bëhet për më pak se një muaj.

Përkundër faktit se institucionet relevante njoftojnë për lëshimet e këtylla, edhe më tej në dokumentacionin e tenderit organet kontraktuese vazhdojnë të mos e precizojnë sesi do ta vlerësojnë elementin “cilësi”, përkatësisht nuk përcaktojnë nënkritere të qarta për vlerësimin e cilësisë. Në këtë mënyrë organet kontraktuese i radhisin në mënyrë subjektive ofertat e pranuar dhe veprojnë në kundërshtim me Ligjin e furnizimeve publike, ku në mënyrë të prerë është theksuar se “organi kontraktues është i detyruar që në dokumentacionin e tenderit të japë shpjegime, të cilat do t’i vlerësojë dhe do t’i zbatojë elementet e kriterit më të volitshëm ekonomik”.

Përveç kësaj, në praktikë ngjan që organet kontraktuese të kriteri “ofertë më e volitshme ekonomike” të shfrytëzojnë edhe elemente të cilat nuk guxojnë të shërbejnë për zgjedhjen e ofertës më të volitshme, por duhet të shërbejnë për vërtetimin të kapacitetit tekniko-profesional të ofruesit. Këtu bien këto elemente: lista referuese; përvoja/vëllimi; njohja e lëndës së furnizimit dhe kapaciteti profesional. Në këtë mënyrë institucionet shtetërore, duke dhënë numër të konsiderueshëm të pikëve për këto elemente, në fakt i favorizojnë ofertat e firmave më të mëdha, duke mos u dhënë mundësi firmave më të vogla, të cilat i plotësojnë kushtet minimale për kapacitet teknik dhe profesional, që të mund të garojnë përmes çmimit dhe cilësisë.

Pa dyshim se të gjitha këto dukuri njoftojnë, veçmas gazetarët, që duhet t’i analizojnë me kujdes kriteret për zgjedhjen e ofertës më të volitshme dhe, përmes bisedave me firmat, të vërtetojnë nëse janë parashtruar kriteret për secilin furnizim ndaras, në mënyrë që të ofrojnë garë të drejtë ose, përkundrazi, dëshmojnë favorizim dhe planifikim paraprak të ndonjë firme të caktuar.

### Rreziqet në fazën e procesit të zgjedhjes së ofertës më të volitshme

Pas mbledhjes së ofertave, vijon faza e evaluimit të ofertave të arritura në firmat. Njëri ndër rreziqet më të mëdha të kësaj faze është evaluimi subjektiv dhe i padrejtë i ofertave të firmave. Praktikisht këtu del në skenë problemi i elementeve joprecize për vlerësim, gjë që pamundëson evaluim të drejtë, por vetëm vlerësim subjektiv të ofertave. Për ekzistimin e këtij problemi flasin edhe ankesat e firmave drejtuar Komisionit Shtetëror për Ankesë ndaj Furnizimeve Publike, të cilat në masë të madhe kanë të bëjnë pikërisht me këtë fazë të procedurave për furnizime publike. Ekzistimin e këtij problemi e vërtetojnë edhe anketat e realizuara nëpër kompani, në të cilat potencohet vlerësimi se njëri ndër problemet kryesore me të cilin ballafaqohen ato është evaluimi jo i drejtë i ofertave dhe favorizimi i ndonjë oferte të caktuar. Pothuajse secila firmë pohon se ballafaqohet me evaluim jo të drejtë të ofertave. Gjatë shpjegimit të përgjigjeve të veta, një pjesë e firmave flasin për fenomenin kur “fituesi njihet që në fillim” për “marrëveshje para tenderit”, për raste kur pikët e evaluimit përshtaten në favor të një pale, por edhe për një vlerësim joadekuat të karakteristikave teknike të ofertave.

Është me rëndësi të dihet se në lidhje me rrezikun e anulimit të procedurave për furnizime publike, nëse nuk realizohen kalkulimet e planifikuara për fitoren e kompanisë së favorizuar, vetë ligji përcakton një listë të gjatë të arsyeve për shkak të të cilave organi kontraktues mund ta anulojë procedurën për furnizim publik, sipas të cilave ai e ka shumë lehtë anulimin e procedurave. Sipas Ligjit të furnizimeve publike, organi kontraktues ka të drejtë ta anulojë procedurën nëse nuk është dorëzuar asnjë ofertë ose asnjë ofertë nuk është e pranueshme; nëse janë dorëzuar oferta të pranueshme, por ato nuk mund të krahasohen për shkak të qasjes së ndryshme në ofertat teknike dhe financiare; nëse dorëzuesit e ofertave kanë parashtruar çmime dhe kushte për realizimin e marrëveshjes, të cilat janë më pak të volitshme se ofertat reale të tregut; nëse

vlerësohet se dokumentacioni i tenderit përmban lëshime qenësore ose mangësi; nëse janë shfaqur ndryshime të paparashikueshme në buxhetin e organit kontraktues; nëse për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive janë ndryshuar nevojat e organit kontraktues ose nëse organi kontraktues nuk mund ta bëjë përzgjedhjen e ofertës më të mirë për shkak të shkeljeve të konsiderueshme të ligjit.

*“Vlerësimi (evaluim) subjektiv dhe jo i drejtë i ofertave të firmave.*

*Anulimi i procedurave nëse nuk realizohen kalkulimet e planifikuara.*

*Zgjatja e tepërt e zgjedhjes së ofertës më të volitshme, me çka krijohet mundësi për garë mes firmave në dhënie të rryshfetit.*

”

ofertë tjetër e pafavorizuar, atëherë organi kontraktues mund ta shfrytëzojë njërin nga arsyet e sipërpërmendura për ta anuluar procedurën. Anulimi, si pikë e dobët në sistemin e furnizimeve, publike potencohet edhe në raportin e fundit të Komisionit Evropian për përparimin e Maqedonisë.

Ekziston rrezik i madh i anulimit të tenderit për shkak të motiveve korruptive, sepse ligji nuk parasheh kurrfarë kontrolli ndaj organeve kontraktuese për vlefshmërinë dhe justifikimin e anulimit të procedurave, madje nuk parashihen sanksione as ndaj anëtarëve të komisionit në rast të lëshimeve subjektive. Në fakt, askush nuk e kontrollon nëse është i arsyeshëm elaborimi i organit kontraktues se patjetër duhet ta anulojë procedurën, për shkak se asnjë ofertë e dhënë nuk ka qenë e pranueshme. Në vend të kësaj, vendimet e kësajllah pranohen pa kurrfarë kritike dhe kontrolli të ndonjë organi të pavarur.

Që të mund të kontrollohen dyshimet për anulimin e qëllimshëm të ndonjë procedure, përsëri rekomandohen bisedime me pjesëmarrësit në tender, të cilët më së miri i njohin rrethanat dhe realisht mund të vlerësojnë nëse prapa vendimit për anulim fshihen manipulime të caktuara. Procedurat e anuluar mund të shihen në Sistemin Elektronik të Furnizimeve Publike. Në fakt, 30 ditë pas dorëzimit të vendimit për anulimin e procedurës, organet kontraktuese e kanë për detyrë t’ia dorëzojnë

raportin e anulimit Byrosë së Furnizime Publike, që ashtu të publikohet në sistemin elektronik. Rrezik tjetër është prolongimi i zgjedhjes së ofertës më të volitshme, me çka krijohet mundësia për garë ndërmjet firmave, se cila do të japë ryshfet më të madh që ta fitojë tenderin. Edhe pse me ndryshimet e Ligjit të furnizimeve publike deri në fund të korrikut të vitit 2010, organet kontraktuese kanë afat përfundimtar për të vendosur, i cili nuk guxon të jetë më i gjatë se periudha prej publikimit të shpalljes, e deri te hapja e ofertave, megjithatë konsiderohet se rreziku i prolongimit të qëllimshëm nuk është plotësisht i vënë nën kontroll. Në fakt, para se të aprovohen këto ndryshime ligjore, disa organe kontraktuese me muaj të tërë nuk merrnin vendime për zgjedhjen e ofertës më të volitshme, duke lejuar kështu rritjen e presionin ndaj firmave që të zbatojnë edhe mënyra joligjore për ta fituar tenderin. Mirëpo, edhe përkundër ndryshimeve ligjore, ka disa organe kontraktuese, të cilat i marrin vendimet pas skadimit të afatit përfundimtar ose presin ta marrin vendimin pikërisht gjatë skadimit të afatit përfundimtar. Ndërkohë, nuk parashihen sanksione për shkeljet e këtilla. Prandaj, duhet insistuar që organet kontraktuese t'i marrin vendimet për ofertat më të volitshme në afate sa më të shkurtra, me çka jo vetëm që do të shmanget rreziku nga keqpërdorimet, por edhe do të rritet efikasiteti i sistemit të furnizimeve publike.

### **Rreziqet në fazën e nënshkrimit të marrëveshjes**

Korrupsioni është i mundshëm dhe real edhe në fazën e nënshkrimit të marrëveshjeve. Njëri nga rreziqet e para të kësaj faze është ndryshimi i kushteve, sipas të cilave marrëveshja nënshkruhet në interes të operatorit ekonomik. Edhe pse format e këtilla të abuzimi të rëndë duken të pamundshme, megjithatë ato ndodhin dhe disa sosh prezantohen publikisht nga Enti Shtetëror i Revizionit. Marrë në përgjithësi, deri në 7.9% të parregullive të furnizimeve publike të konstatuara nga Enti Shtetëror i Statistikës në vitin 2009 kanë të bëjnë me fazën e nënshkrimit të marrëveshjeve. Janë nënshkruar marrëveshje, të cilat nuk i përmbajnë elementet themelore të dokumentacionit të tenderit dhe ofertës, siç janë: çmimi, sasia ose vlera, por edhe kontrata me kushte të ndryshme nga kushtet e dhëna në ofertat ose dokumentacioni e tenderit, me vlerë më të lartë se ajo vendimeve për furnizime publike ose me vlerë më të madhe se plani për furnizime publike. Kështu realizohen kontrata më larta se shumica e kontraktuar ose vlera e ndërhyrjeve plotësuese e tejkalon kufirin e paraparë ligjor. Sipas Ligjit të furnizimeve publike, nëse paraqiten rrethana të parapara, institucionet kanë të drejtë të bëjnë furnizim të punëve ose shërbimeve plotësuese nga firma, me të cilën kanë nënshkruar kontratë me vlerë e cila nuk guxon ta tejkalojë 30%-shin e vlerës së kontratës bazë, ndërsa kohëzgjatja e punëve ose shërbimeve plotësuese nuk mund të jetë më e gjatë se tre vjet që nga nënshkrimi i kontratës bazë. Sipas konstatimeve të revizorëve gjatë realizimit të kontratave, shpeshherë nuk respektohen afatet dhe kushtet për plotësimin e lëndës së furnizimit, organet kontraktuese nuk i shfrytëzojnë dispozitat ndëshkuese të parapara me kontratën, ndërsa garancitë e dorëzuara nuk aktivizohen në rastet e parapara në kontratën konkrete.

Gjithsesi se pjesa më e madhe e këtyre ndryshimeve janë bërë në interes të firmave, prandaj lind pyetja se çka kanë fituar organet kontraktuese ose individë të tyre që të pajtohen për ndryshime të këtilla në dëm të institucioneve dhe buxhetit. Rreziku i dytë i keqpërdorimit është nënshkrimi i kontratave të prodhuesve gjatë realizimit të furnizimeve publike. Ligji i detyron institucionet që në procedurat për furnizime publike të kërkojnë prej firmave të potencojnë nëse do të angazhojnë nënrealizues. Nga ana tjetër, nuk ekzistojnë kufizime se çfarë pjesë e detyrimeve të kontratës mund të bie mbi nënrealizuesit. Kjo zbrazëti ligjore u mundëson firmave, që e kanë fituar tenderin, pa kurrfarë transparence të angazhojnë nënrealizues. Në këtë mënyrë ndodhë që firma ta fitojë tenderin për shkak të ekspertizës së saj, cilësisë që e garanton, personelit profesional dhe përvojës, ndërsa praktikisht punët t'i kryejë ndonjë firmë tjetër, me çka kontestohet efikasiteti dhe racionaliteti i shpenzimit të të parave publike.

Gatekeeping dhe institucioneve që opinionit të gjerë t'i mundësojnë qasje në informacionet për furnizime konkrete të kontraktuara, paraqet garanci se gjatë zgjedhjes së ofertës më të volitshme respektohen rregullat, ndërsa të hollat e qytetarëve harxhohen në mënyrë adekuate, efikase dhe racionale. Për shkak të mungesës së të dhënave dhe për shkak të mosdhënies së llogarisë, krijohet mundësi për aktivitete të mundshme joligjore dhe korruptive gjatë realizimit të furnizimeve publike. Ligji i furnizimeve publike parasheh se institucionet janë të detyruara që në sistemin e informimit të Byrosë së Furnizimeve Publike të dorëzojnë/shpallin raportime për kontratat e nënshkruara për furnizime me vlerë më të lartë, kjo në afat prej 39 ditësh deri në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes. Hulumtimet e realizuara në vitet e kaluara dëshmojnë se institucionet nuk e respektojnë me përpikëri këtë detyrim ligjor. Me qëllim që t'i nxisë në dëgjueshmëri organet kontraktuese,

“*Ndryshimi i kushteve sipas së cilave nënshkruhet marrëveshja në interes të operatorit ekonomik. Përfshirja e nënrealizuesve gjatë realizimit të furnizimeve publike, të cilët zgjidhen në mënyrë jo-transparente. Mungesa e transparencës gjatë shpalljes së marrëveshjeve të nënshkruara.*”

Byroja e Furnizimeve Publike në vitin 2010 ka shqiptuar edhe ndalesa administrative për publikimin e shpalljeve të reja për furnizime publike për institucionet, të cilat nuk kanë dorëzuar raport për kontratat paraprakisht të nënshkruara për furnizime publike. Prandaj, duhet të dihet se informacionet për kontratat e nënshkruara me detaje për atë se çka, prej kujt dhe për sa të holla është blerë janë publike dhe nëse ato nuk gjenden në SEFP, atëherë gazetarët kanë të drejtë t'i kërkojnë nga institucioni që e ka nënshkruar kontratën për furnizim publik.

### **Rreziqet në fazën e zbatimit dhe mbikëqyrjes së kontratës**

Ligji i furnizimeve publike i rregullon procedurat vetëm deri në momentin e nënshkrimit të kontratave për furnizime publike. Me aktin e nënshkrimit të kontratës pushojnë kompetencat e ligjit dhe institucioneve, puna e të cilave është e rregulluar me atë ligj (Byroja e Furnizimeve Publike dhe Komisioni për Ankesa ndaj Furnizimeve Publike). Njëra ndër fazat mjaft të rëndësishme, siç është realizimi i kontratave, e cila ka edhe rreziqe të shumta nga keqpërdorimet, ngelë jashtë fushëveprimit të Ligjit të furnizimeve publike dhe institucioneve kompetente për furnizime publike.

Prandaj parashtrohet edhe pyetja – a kontrollohet apo sa kontrollohet në Maqedoni përmbajtja e kontratës për furnizime publike dhe a realizohet me të vërtetë procedura sipas marrëveshjes së arritur, përkatësisht sipas kushteve të përcaktuara. Ekspertët konstatojnë se në vend nuk ka mekanizëm efikas për kontrollimin e realizimit të kontratave për furnizime publike. Edhe Enti Shtetëror i Revizion është i limituar në këtë segment, jo vetëm për shkak të kontrolleve të rralla në institucione të caktuara, por edhe për shkak të ingerencave të kufizuara ligjore për përcjelljen e realizimit të kontratave të nënshkruara. Rol kryesor në zbulimin e abuzimeve gjatë realizimit të kontratave për furnizime publike kanë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia Financiare, të cilat deri më tani nuk kanë shfaqur interes të madh për zbulime në këtë sferë.

Për shkak të kontrollit të dobët të realizimit të kontratave për furnizime publike, shfaqet edhe një problem tjetër serioz i cili mund ta stimulojë korrupsionin. Fjala është për rrezikun minimal të sanksionimit të abuzimeve të zbuluara në procedurat e furnizimeve publike, si në rastet kur revizorët zbulojnë një sërë parregullsish dhe ato i dorëzojnë në Prokurorinë Publike. Prokuroria Publike, në bazë të raporteve të pranuar nga Enti Shtetëror i Revizionit për parregullsitë e përcaktuara dhe për shkak të punës joligjore të palëve kontraktuese, shpeshherë nuk gjen bazë për ndjekje penale, ndërsa në rastet kur ka dyshim për vepër penale, kërkon nga MPB-ja të ndërmarrë veprime plotësuese për zbulim. Mirëpo, zakonisht në këtë shkallë ndërpritet tërë procedura. Për shkak të prolongimit ose për shkak se Prokurorisë i mungojnë provat nga veprimet e kërkuara për zbulim plotësues, praktikisht pamundësohet marrja e vendimit gjyqësor (procedura penale) për punë të paligjshme dhe shpenzim të mjeteve publike.

Në drejtim të kontrollit të fuqizuar dhe sanksionimit të keqpërdorimeve në furnizimet publike nuk ndihmon as Ligji i kontrollit publik dhe të brendshëm financiar, emri i të cilit sugjeron kompetencë të mundshme të revizorëve të brendshëm dhe/ose të Sektorit për Kontroll Publik të Brendshëm Financiar brenda Ministrisë së Financave në lidhje me përcaktimin e parregullive të punës financiare të organeve kontraktuese.

Megjithatë, qëllimi i këtij ligji, të cilin e vërteton edhe praktika e deritanishme, është të mbrohet personi përgjegjës i organit shtetëror nga abuzimet e mundshme të punëtorëve. Kjo do të thotë se, edhe nëse vërtetohet puna e paligjshme në procedurën e furnizimit publik, masa në kuadër të organit kontraktues në atë rast do të merren gjithnjë në mënyrë interne.

“

*Mungesa e mbikëqyrjes së fuqizuar në lidhje me mënyrën e nënshkrimit të marrëveshjeve.*

*Rrezik minimal nga sanksionimi i keqpërdorimeve të zbuluara në procedurat e furnizimeve publike.*

*Zgjatja e tepërt e realizmit të marrëveshjeve të ndara dhe vonimi i pagesës së të hollave si mënyrë për stimulim të ryshfetit.*

”

Një pjesë e madhe e firmave të Maqedonisë, të cilat kanë nënshkruar kontrata me institucionet shtetërore në nivel qendror ose në atë vendor ankohen edhe për shkak të zgjatjes së tepërt të realizmit të kontratave të fituara, gjegjësisht ankohen për shkak të vonimit të pagesës së të hollave. Mënyra e këtillë e sjelljes së institucioneve mund të jetë shtytje serioze për korrupsion, për shkak se i vë firmat në pozitë që të shfrytëzojnë edhe metoda joligjore, siç është ryshfeti, me qëllim që ashtu t'i stimulojnë organet kontraktuese që t'i realizojnë kontratat për furnizime publike. Prandaj është e domosdoshme që gazetarët të komunikojnë me firmat dhe me asociacionet e tyre (odat ekonomike), me qëllim që të informohen për problemet eventuale në realizimin dhe pagesën e kontratave për furnizime publike, për shkak të rrishtit të paraqitjes së korrupsionit.

### **(Mos)besueshmëria e të dhënave të kontratave për furnizime publike**

Duke i pasur parasysh të gjitha këto rreziqe nga korrupsioni në furnizimet publike, rekomandimi i përgjithshëm për gazetarët është që ato të ndiqen dhe të analizohen nga ideja e deri te realizimi, si dhe gjithnjë të insistohet në deklaratat dhe interpretimet e vetë pjesëmarrësve në tenderë, si nga firma që e ka fituar kontratën, ashtu edhe nga firmat që e kanë humbur tenderin. Në komunikim me organet kontraktuese gazetarët kanë të drejtë të kërkojnë qasje në të gjitha dokumentet, të cilat kanë qenë lëndë e procedurës që prej publikimit të shpalljes, përmes dokumentacionit të tenderit, e deri në marrjen e vendimit për zgjedhjen e kompanisë fituese. Nëse gazetarët ballafaqohen me probleme gjatë mbledhjes së këtyre të dhënave, ata mund ta përdorin Ligjin për qasje të lirë në informacione të karakterit publik. Njashtu duhet ditur se në procedurat për furnizime publike janë të besueshme vetëm të dhënat, të cilat do të trajtohen si të tilla nga vetë firmat. Në kuadër të informacioneve të besueshme nuk bien çmimet, specifikacionet e ofertave ose kushtet në bazë të të cilave ofrohen mallrat dhe shërbimet, por edhe disa sekrete dhe të drejta afariste të pronës intelektuale. Organet kontraktuese kanë të drejtë që gazetarëve të mos u dorëzojnë kopje të kontratave të plota për furnizime publike, në të cilat rregullohen të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese, nën arsyetimin se rrezikohet interesi afarist i kompanisë, por kjo nuk do të thotë se ata kanë të drejtë të mos i publikojnë të dhënat për kushtet, në bazë të të cilave është lidhur kontrata, që publikisht të dihet se sa i ka kushtuar buxhetit shtetëror ndonjë furnizim i caktuar.

# INSTITUCIONET KOMPETENTE NË FURNIZIME PUBLIKE

Që të mund të raportojnë drejt për furnizimet publike dhe ta dinë se cilit institucion duhet t'i drejtohen që të marrin informacion të caktuar dhe të njoftohen me procedurat e furnizimeve publike, për gazetarët është me rëndësi t'i dinë ingerencat e të gjitha institucioneve që janë të inkuadruara në sistemin e furnizimeve publike. Institucionet që në mënyrë të drejtpërdrejtë janë të përfshira në procesin e furnizimeve publike në Maqedoni janë Byroja e Furnizimeve Publike dhe Komisioni Shtetëror për Ankesa ndaj Furnizimeve Publike, ndërsa në mënyrë të tërthortë janë të përfshira edhe Gjykata Administrative dhe Enti Shtetëror i Revizionit, ndërsa një sasi ingerencash e kanë edhe Prokuroria Publike dhe Avokati Shtetëror.

## **Byroja e Furnizimeve Publike (BFP)**

Byroja e Furnizimeve Publike është organ i administratës shtetërore që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave dhe ka statusin e personit juridik. Drejtorin e Byrosë së Furnizimeve Publike e emëron dhe shkarkon Qeveria me propozim të ministrit të Financave. Mandati i tij është katër vite. Byroja i ka këto ingerenca:

- inicion propozime për miratimin akteve ligjore dhe akteve të tjera nga fusha e furnizimeve publike të adresuara te ministri i Financave;
- e ndjek dhe e analizon zbatimin e ligjeve dhe të rregullave të tjera për furnizime publike, funksionimin e sistemit të furnizimeve publike dhe inicion ndryshime për përmirësimin e sistemit të furnizimeve publike;
- jep mendim në raport me parimet dhe zbatimin e Ligjit të furnizimeve publike;
- siguron këshilla dhe ofron ndihmë për palët kontraktuese dhe operatorët ekonomikë;
- mban evidencë të vetme të kontratave për furnizime publike dhe e mirëmban dhe azhurnon atë, duke e bërë publike përmes ueb-faqes së saj;
- i mbledh, përpunon dhe i analizon të dhënat për furnizimet publike dhe përgatit raporte statistikore;
- i përcakton kushtet minimale për kualifikimin profesional të personave që kryejnë punë profesionale me furnizimet publike;
- organizon dhe realizon trajnim për edukimin e nëpunësve dhe personave të tjerë profesionalë në lidhje me furnizimet publike etj.

Nga kjo del se gazetarët mund ta konsultojnë Byronë e Furnizimeve Publike kryesisht për të marrë koment rreth rregullimit ligjor në sferën e furnizimeve publike, rreth problemeve në respektimin e Ligjit të furnizimeve publike, për mendim profesional rreth një procedure të caktuar për furnizim publik, për të dhëna statistikore për furnizimet publike, për vlerën e kontratave të lidhura etj.

## **Komisioni Shtetëror për Ankesa ndaj Furnizimeve Publike (KSHAFP)**

Ky komision shtetëror është kompetent për zgjidhjen e ankesave në procedurat e ndarjes së kontratave për furnizimet publike dhe ai vendos për respektimin e ligjit në këtë sferë. Kryetari dhe anëtarët e KSHAFP-së i emëron Kuvendi i R.M.-së me mandat prej pesë vitesh. Secili operator ekonomik që ka interes për të marrë kontratë për furnizim publik, kërkon mbrojtje juridike nga KSHAFP-ja. Ankesat dorëzohet në afat prej tetë ditësh (përfshirë ditën e depozitimit të kërkesës për ndarjen e kontratës për furnizim publik dhe marrja e dokumentacionit të tenderit, përmes hapjes së ofertave, e deri te vendimi për zgjedhjen e ofertës më të mirë.

KSHAFP-ja mund të marrë vendime për:

- ta hedhur poshtë ankesën për shkak të moskompetencës, vonesës ose parregullsisë;
- refuzimin e ankesës për shkak se nuk ka bazë;
- për shfuqizimin e vendimit për zgjedhjen e ofertës më të volitshme ose për një pjesë të procedurës që është joligjore;
- për anulimin e qëllimit të procedurës për furnizim publik kur konstatohen parregullsi të mëdha.

Gazetarët mund ta konsultojnë KSHAFP-në për rrjedhën e procedurës për ankesa të caktuara që janë në interesin e tyre, por njëherazi edhe për vlerësimin e përgjithshëm të gjendjeve në sferën e furnizimeve publike në pjesën e mbrojtjes juridike.

Gjykata administrative e R.M.-së

Gjykata Administrative është kompetente që të vendosë për kontestet administrative në sferën e furnizimeve publike. Nëse janë të pakënaqura nga vendimi i KSHAFP-së, firmat, personat fizikë, por edhe organet kontraktuese mund të parashtrojnë ankesë në Gjykatën Administrative ndaj vendimit të komisionit të shkallës së dytë të ankesave për furnizime publike.

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR)

Në pajtim me Ligjin e furnizimeve publike, revizionin e përdorimit dhe shpenzimit të mjeteve për furnizime publike e bën ESHR-ja, ndërsa mënyrën sesi ajo e kryen revizionin ndaj punës materiale-financiare, kjo është e rregulluar në Ligjin e revizionit shtetëror. Parregullsitë në sferën e furnizimeve publike revizorët i ndajnë në disa kategori: procedura të parealizuarra për furnizime publike; dobësi në fazën e evaluimit, propozim për zgjedhjen e ofertës më të volitshme dhe miratim i vendimit për zgjedhje; dobësi në fazën e nënshkrimit të marrëveshjeve me operatorët ekonomikë pas procedurës së zbatuar të furnizimit publik; dokumentacioni i tenderit nuk është në pajtim me ligjin; realizimi i marrëveshjeve mbi shumën e kontraktuar e kështu me radhë.

Raportet e kontrollimeve, në të cilat janë regjistruar keqpërdorim dhe shkelje të ligjit në shpenzimin e parave publike, dorëzohen në Prokurorinë Publike.


Prokuroria publike

Në pajtim me Kushtetutë, Prokuroria Publike është organ që e mbron interesin shoqëror dhe që i ndjek kryerësit e veprave penale dhe veprave të tjera të ndëshkueshme. Në këtë drejtim cenim i interesit shoqëror mund të ketë edhe gjatë realizimit të marrëveshjeve për furnizime publike, me ç'rast mund të bëhen më shumë vepra penale që janë përshkruar me Kodin Penal (për shembull: keqpërdorimi i detyrë zyrtare, mashtrimi...).

Bazë më të shpeshtë të veprimit të Prokurorisë Publike në fushën e furnizimeve publike paraqesin raportet e revizionit që dorëzohen në Prokurori. Por, Prokuroria Publike mund të veprojë edhe nëse në opinion ka zëra për abuzime dhe shkelje të ligjit në shpenzimin e parave të popullit.

Avokati Shtetëror

Avokati Shtetëror është organ që ndërmerr masa dhe veprime juridike me qëllim të mbrojtjes juridike të të drejtave dhe interesave pronësore të Republikës së Maqedonisë. Mbrojtjen e këtillë e realizon para gjykatave dhe organeve të tjera në vend dhe jashtë. Në pajtim me Ligjin e furnizimeve publike, Avokati Shtetëror ka të drejtë të kërkojë mbrojtje juridike në procedurat e furnizimeve publike. Por, në pajtim me Ligjin e Avokatit Shtetëror, veprimet që merren nga ky organ varen nga kërkesa e dorëzuar në organet kontraktuese ose te cilido person tjetër fizik ose juridik që ka interes juridik.



**CIP** – Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека  
„Св. Климент Охридски“, Скопје

35.073.53(497.7) (035)

**DORACAK** për gazetarë për hulumtim dhe  
raportim në lidhje me furnizimet publike. –  
Skopje: Centar za graganski komunikacii, 2011.  
– 40 стр. : граф. прикази; 30 см

**ISBN** 978-9989-2756-3-0

а) Јавни набавки – Македонија – Прирачници  
COBISS.MK-ID 87753482